

**BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE**

**VOLUMI 6**

**(Korrik– Dhjetor 2019)**

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE .....	4
1. Vendim Nr.2789 Datë 24.10.2019 .....	4
2. Vendim Nr.2129 Datë 04.07.2019 .....	5
3. Vendim Nr. 1999 Date 27.06.2019 .....	7
4. Vendimi nr. 2731 datë 17.10.2019 .....	9
5. Vendim Nr. 2814, Datë 29.10.2019 .....	10
6. Vendim Nr.2359 Datë 12.09.2019 .....	12
7. Vendim Nr.1551 Datë 21.05.2019 .....	14
8. Vendim Nr. 468 Datë 07.10.2019 .....	17
9. Vendim Nr. 42 Datë 04.02.2019 .....	18
10. Vendim Nr. 3301 Datë 19.12.2019 .....	19
11. Vendim Nr. 1941 Datë 20.06.2019 .....	21
12. Vendim Nr. 1963 Datë 20.06.2019 .....	24
13. Vendim Nr.2596 Datë 3.10.2019 .....	26
14. Vendim Nr. 2935, Datë 07.11.2019 .....	27
15. Vendim Nr. 605 Datë 10.07.2019 .....	35
16. Vendim Nr. 2530 Datë 26.09.2019 .....	37
17. Vendim Nr. 3151 Datë 12.12.2019 .....	41
18. Vendim Nr. 2325 Datë 11.09.2019 .....	51

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në faqen legjislacionin, në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c/legjislacioni>

### ***Shënim!***

*Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.*

# **PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE**

## **Pavlefshmëria Relative**

### **1. Vendim Nr.2789 Datë 24.10.2019**

## **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Padites:** Shoqëria “A.L”

**I paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor

**Objekti:** Shfuqizim i njoftim vleresimit nr. \_\_, datë 01.04.2011 dhe vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimpaguesve nr. \_\_, date 18.07.2011

**Shuma e detyrimit tatimor:** 33.495.652 leke

## **Baza Ligjore:**

1. Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nenet 81, 83, 84, 109, 114 dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008;
2. Ligji nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar, nenet 4 dhe 38.

## **Përmbledhje e Fakteve:**

Njoftim vlerësimi objekt padie konsiston në detyrime për vitin 2010, konkretisht: detyrim tvsh- je për rivlerësim për moslëshim fature të saktë dhe gjobë në masën 100 % të detyrimit për moslëshim faturë të saktë, dënim për detyrim tatim fitimi për moslëshim fature të saktë, detyrim akcize të pallogaritur dhe interesa për mospagim akcize, gjobë për mosllogaritje dhe mosderdhje të akcizës sa dyfishi i akcizës së papaguar, gjobë për mospaisje dhe mosautorizim dhe magazine tatimore.

## **Vlerësimi i Gjykatës:**

Sa i takon detyrimit për akcizën, Gjykata vlerëson se për sa kohe nafta e shitur nga paditesi nuk rezulton e shitur për perpunim në rafineri naftë apo kompanive të tjera të licensuara të tregtimit me shumice të këtij malli, organet tatimore me të drejtë kanë vendosur tarifën për akcize duke qenë se malli është shitur si zevëndesues lëndë djegëse.

Sa i takon detyrimit të TVSH, Gjykata vlerëson së referuar ligjit 6942, datë 25.12.1984, përgjegjësia e llogaritjes së firove ligjore i takon komisionit të inventarizimit, i cili në rastin në fjalë inicohet dhe kryesohet nga inspektori tatimor. Referuar edhe aktit të ekspertimit mbajtur nga eksperti i pavarur, Gjykata ka llogaritur firot, duke u shprehur se konstatimi i inspektorëve tatimore që nuk i

kanë marrë parasysh firot, por i kanë konsideruar ato si diferencë në sasi për artikullin bitum i lëngët, është i gabuar.

**Vendim:** Shfuqizim të pjeshëm të aktit administrativë.

## **2. Vendim Nr.2129 Datë 04.07.2019**

### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “R.F”

**I Paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

**Objekti:** 1-Shfuqizim i pikës 2 të Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Nr.\_\_\_\_ Prot, datë 30.12.2015 dhe pikës 1 të konkluzioneve të Raport – Kontrollit Nr.\_\_\_\_, datë 30.12.2015 të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, për pjesën e lenë në fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor.

2-Anullimin dhe sistemim në ulje të kreditimit të pjesshëm të TVSH-se për shumën 20,592,970 leke në periudhën dhjetor 2014.

3-Shfuqizim i pikes 1/2 të Vendimit Nr.\_\_\_\_ Prot, datë 15.03.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor në lidhje me Gjobën prej 4,077,408 Lekë të vendosur për sistemimin e TVSH-së (ulje të tepricës kreditore).

#### **Shuma e detyrimit tatimor:**

**1. Detyrimi - 21.846.496**

**2. Gjoba - 4.077.407**

#### **Baza Ligjore:**

1. Kodi i Procedurave Civile, nenet 31, 32;
2. Ligji nr.49/2012 “ Për gjykatat administrative”, nenet 7/a,10,11/1,15/a,16/1,17/1a,c,e 40/1a ;
3. Ligji nr.92/2014 dt.27.04.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, neni 76 ;
4. Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008;
5. Kodi i Procedurave Administrative, nenet 18, 23,101,112,118,131,132,138.

#### **Përmbledhje e Fakteve:**

Nga kontrolli i blerjeve të vitit 2014, ka rezultuar se blerjet brenda vendit në shumën 27.410.180 lekë, përbëhen nga blerjet e mallrave me TVSH. Krijimi i kësaj TVSH-je kreditore ka ardhur për arsye të ndërtimit të objektit të shoqërisë në vitin 2013. Raporti i mëparshëm i kontrollit nuk e ka njohur kreditimin e plotë të TVSH-së së këtij objekti dhe rezultatet e këtij raporti janë ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor dhe më tej në gjykatë nga shoqëria. Aktualisht, është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe vendimi është në favor të shoqërisë.

Shoqëria nuk e ka bërë rregullimin e kreditimit dhe ka pretenduar se as kontrolli tatimor nuk duhet të bëjnë rregullimin e kreditimit të TVSH-së.

### **Vlerësimi i Gjykses:**

Raport kontrolli i mëparshëm për të cilin shoqëria është ankimuar në Gjykatë, dhe Vendimi i Gjykatës së Apelit që ka qënë në favor të shoqërisë është i lidhur pashmangshmërisht me përcaktimin e kreditimit të TVSH-se në Njoftim Vleresimit objekt padie. Në raportin e kontrollit objekt shqyrtimi është përcaktuar se ulja e teprices kreditore dhe gjoba do të vendosen nga përfundimi i gjykimit të Njoftim Vleresimit nr.\_\_\_\_ dt.24.07.2014 për rregullimin përfundimtar të kreditimit të TVSH-së. Administrata tatimore nuk duhej të vepronte me penalizimin e pales paditese për moskryerjen prej shoqërisë të një detyrimi për sistemimin e shumës së TVSH-se të pa miratuar për rimburesim, pa u zgjidhur përfundimisht nga Gjykata ceshtja e refuzimit të kërkesës së shoqërisë për rimburesim. Me vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Apelit nr. \_\_\_\_dt.30.05.2017 të cilin DTM e ka zbatuar, ku shoqërisë i është miratuar në thelb rimburesimi i TVSH-së, së paguar për blerjen e ndërtimit të magazines farmaceutike, kanë rënë në themel dhe arsyet e DTM për vendosjen e gjobes 4,077,407 leke dhe sistemimi i uljes të kreditimit të pjesës për periudhën Dhjetor 2014.

### **Vendim:**

1-Lënie në fuqi të Vendimit të Gjykatës të Shkalles së Parë nr.\_\_\_\_ dt.28.06.2016.

2-Pranimin e padisë të shoqërisë “R.F”

### **3. Vendim Nr. 1999 Date 27.06.2019**

#### **Gjykata Administrative e Apelit Tirane**

**Padites:** Shoqëria "X"

**I paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

**Objekti:** Shfuqizimi i Njoftim Vleresimit Tatimor nr. \_\_\_ prot, dt. 17.11.2015

Shfuqizimi i Vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. \_\_\_ dt. 15.03.2016

**Shuma e detyrimit tatimor:** 119,898,351

#### **Baza Ligjore:**

1-Ligji nr.9920 dt.19.05.20108 i ndryshuar, nenet 68,70,71,106 e vijues.

2-Ligji nr.7928dt.27.04.1995 "Per Tvsh" nenet 10,18,24,28 34 Udhezimi MF nr.17;

3-Ligji nr.8438 dt.28.12.1998 "Per Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar neni 31;

4-Udhezimi nr.5 dt.30.01.2006 "Per Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

5-Ligji nr.49/12 dt.03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative' dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative"

#### **Përmbledhje e Fakteve:**

Shoqëria ka shitur në formën e paketës mall (karta sim) dhe shërbim (kohe bisedore telefonike)

Këto dy artikuj kanë një vlerë specifike, ku përfshihet vlera e kartës dhe vlera e kohës bisedore. Përkundrazi shuma e këtyre dy vlerave është ajo që duhet të pasqyrohet në faturat e shitjes, ndërsa pasqyrimi i reduktuar i kësaj vlerë është objekti i rivleresimit tatimor. Por pasqyrimi në formën e pakeës nënkupton që artikujt përberës të kësaj pakee duhet të shiten në vlerën e tyre reale. Nga shoqëria në faturat tatimore nuk është pasqyruar si njësi matëse koha bisedore, çka do të thotë se faturat tatimore ku pasqyrohet shitja e shërbimit pasqyrohet vetëm me leke.

Koha bisedore e deklaruar si pjesë e paketës së shitur është vlerësuar në njësinë matëse të deklaruar nga vetë shoqëria, e cila është LEKE. Shoqëria nuk ka përshkruar çmimin përkatës për çdo njësi shërbimi të kryer, nëse do të përcaktonte njësinë e shërbimit, sasinë e shërbimit vlera e tatueshme e furnizimit do të dilte si rezultat i llogaritjes së këtyre elementëve (ashtu siç ndodh rëndom në çdo furnizim tjetër shërbimi).

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

1-Karta SIM e konsideruar veçmas nga koha bisedore që përmban është një pajisje/material që do të konsumohet gradualisht gjatë ofrimit të telefonisë celulare, nga përdorimi i të cilit priten

perfitime te ardhshme. Karta SIM nuk ka asnje vlere tjeter veç krijimit te aksesit te pajtimit ne rrjetin e shërbimit te shoqërisë. Ajo ben te mundur lidhjen e aparatit celular te pajtimtarit me kete rrjet.

2-Nga ana e pales së paditur nuk është identifikuar drejt në vlerësimin tatimor’ “Natyra e produktit/paketes se quajtur SIM CARD me parapagim dhe elementet e kostos dhe të ardhurave që duhen marre në Konsideratë për vlerësimin e shitjeve nën kosto te SIM CARD. Rezulton qe SIM CARD është një material që duke kontribuar per ofrimin e shërbimit të telefonisë gjeneron te ardhura te tatueshme për shoqërine në një kohë të papërcaktuar. Në këtë kuptim, ndryshe nga sa kane vepruar inspektoret e tatimeve, vlerësimi per efekte fiskale nese karta Sim eshte furnizuar kundrejt pageses se reduktuar(shitje nen kosto) duhet bere duke marre ne konsiderate natyren specifike te kesaj pajisjeje që gjeneron te ardhura te tatueshme per periudhat e ardhshme pas shitjes. SIM CARD ne vetvete nuk është produkt apo mall i vecantë. Shoqëria ka shitur në fomën e paketes mall që eshte karta SIM dhe shërbim qe eshte koha bisedore. Shuma e këtyre vlerave është ajo qe duhet të pasqyrohet ne faturen e shitjes dhe pasqyrimi i reduktuar i kësaj shume do te ishte objekt i rivlerësimit tatimor

3-DTM nuk ka marre ne konsiderate te ardhurat qe vijne nga interkonjeksioni te cilat vijne si rezultat I kohes bisedore se bashku me karten.Çdo SIM CARD që shet shoqëria përfiton të ardhura nga thirrjet hyrese ne rrjet nga operatorët kombetare dhe nderkombetare.Duke qene se karta SIM shitet si pakete se bashku me nje kohe bisedore konsumi I kesaj kohe bisedore realizon te ardhura shtese nga tarifat e interkonjeksionit te cilat duhet te merren ne considerate per te vlerësuar nese SIM CARD jane shitur nen kosto.

4-Kosto/tarifa e aktivizimit nuk është një tarife e aplikueshme për çdo SIMCard që shitet por vetëm nëse karta kryen rimbushje. DTM në mënyre të gabuar ka marre koston e kohës bisedore të barabartë me çmimin e shitjes së saj.Vlerësimi i shitjeve kundrejt pageses së reduktuar nuk mund të bëhet nga DTM mbi bazen e prezumimit (duke barazuar koston e kohes bisedore me çmimin e shitjes).

#### **Vendim:**

1-Ndryshimin e Vendimit të Gjykates Administrative të Shkallës së Parë nr.190 dt.30.01.2017

2-Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim Vlerësimit nr.\_\_ dt.17.11.2015



#### **4. Vendimi nr. 2731 datë 17.10.2019**

#### **Gjykata Administrative e Apelit**

**Padites:** “XX”

**I Paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve te Medhenj

#### **Objekti:**

1. Shfuqizimi i Njoftim Vleresimit nr. \_\_ prot., dt. 27.11.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore te Tatimpaguesve te Medhenj
2. Shfuqizimi i Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr. \_\_ prot., dt. 23.03.2016

**Shuma e detyrimit tatimor:** 44,149,814 leke

#### **Baza Ligjore:**

1. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 85;
2. Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2014 i Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”

#### **Përmbledhje e fakteve:**

Qëllimi i rikontrollit është verifikimi i procedurave ligjore për zbatimin e urdhër bllokimit të llogarive bankare të shoqërisë “YY” sh.p.k. me NIPT \_\_, të nxjerrë nga DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj me nr. \_\_ prot., datë 17.08.2012. Kontrolli i mëparshëm ka përcaktuar gjobën për transaksione për vitet 2012 dhe 2013 në shumën 23.075.917 lekë, të cilën shoqëria e ka pranuar.

Nga DRTTM është dërguar urdhër bllokimi nr. \_ prot., datë 17.08.2012 i llogarive bankare të shoqërisë “Energji” dhe të llogarive rrjedhëse dhe depozitë të administratorit të saj, pasi kjo shoqëri ka detyrime ndaj DTM në shumën 52.684.742 lekë. Urdhër bllokimi është nxjerrë në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 89 dhe 90. Nga verifikimi i kryer është konstatuar se shoqëria “XX” ka marrë njoftim dhe ka marrë urdhër bllokimin në datë 24.08.2012. Nga kontrolli u verifikuan gjendje dhe lëvizjet e llogarive të shoqërisë “YY” sh.p.k. dhe llogaritë e administratorit si dhe kontratat e huave të marra në bankën “XX”. Gjendja e parave e gjetur në llogari i perket overdaftit që ka marrë shoqëria pranë bankës. Banka nuk ka zbatuar urdhrin e bllokimit të marre nga DTM duke penguar administratën në mbledhjen e detyrimit tatimor të shoqërisë “YY”.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Përsa i përket aspektit procedural të rikontrollit, konstatohet se rikontrolli është kryer në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 85 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

Pretendimet e pales paditese se overdrafti nuk përfshihet në llogaritë bankare të tatimpaguesit, të cilat mund të bllokohen dhe ekzekutohen për llogari të administratës tatimore, bien ndesh me legjislacionin që nuk e ka përjashtuar overdraftin nga llogaritë që duhet të bllokohen dhe më tej të ekzekutohen. Ligji për Procedurat Tatimore nuk të referon në asnjë moment të Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2014 i Bankës së Shqipërisë “*Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë*” dhe për këtë shkak përkufizimi i termave sipas këtij udhëzimi nuk është i detyrueshëm për veprimet e përcaktuara në Ligjin 9920. Termi “llogari bankare” i përdorur në Ligjin 9920 përfshin çdo lloj llogarie të tatimpaguesit që ka detyrime të paslyera, pasi vetë qëllimi i ligjvënësit ka qënëmbledhja e çdo shume që tatimpaguesi ka në dispozicion në llogaritë e tij bankare apo depozitë. Interpretimi ndryshe i kësaj dispozite jo vetëm do të binte ndesh me qëllimin e ligjvënësit gjatë hartimit të kësaj dispozite, por gjithashtu do të krijonte mundësinë e shmangies së pagesës së detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit. Dhënia e kredive tatimpaguesve debitorë ndaj administratës tatimore dhe moskalimi i kësaj shume për llogari të administratës tatimore, është një hapësirë që i krijohet tatimpaguesve që ata të kryejnë pagesa duke shmangur shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe duke mos zbatuar radhën e ekzekutimit të përcaktuar nënenin 605 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”. Forma e zbatimit të nenit 90 të Ligjit për Procedurat Tatimore nga banka do t’a shndërronte këtë nen në një dispozitë pa vlerë, pasi nuk do të arrinte qëllimin për të cilin është krijuar.

Në rastet kur banka gjykon për mosëkzekutimin e urdhërave të administratës tatimore, ligjvënësi ka përcaktuar dënime për këto institucione, çka përforcon arsyetimin e mësipërm për antiligjshmërinë e veprimeve të kryera nga banka.

**Vendim:** Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr.2731 dt.17.10.2019 ka vendosur:

1-Lënien në fuqi të Vendimit nr.3530 dt.06.07.2016

2-Rrëzimin e padisë të shoqërisë “XX”

## **5. Vendim Nr. 2814, Datë 29.10.2019**

**Padites:** Shoqëria “A.H”

**I Paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj

**Objekti:**

1. Shfuqizimi i Njoftim Vlerësimit nr.\_\_\_\_ dt.04.03.2019.
2. Shfuqizim i pjesshëm i Vendimit nr.\_\_\_\_ dt.27.05.2016 të DAT-se për pjesën e lënë në fuqi të Njoftim Vlerësimit

**Shuma e detyrimit tatimor:** 54,349,271 leke.

**Baza Ligjore:**

- 1- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 109
- 2- Ligji nr.7928, dt 27.04.1995 “Per tatimin mbi vleren e shtuar”, neni 33 dhe udhëzimi nr.17 dt.13.05.2008, i ndryshuar, pika 18, 19.
- 3- Neni 7,11,15/a I Ligjit nr49/2012

### **Përmbledhje e Fakteve:**

Shoqëria është penalizuar për kreditim të gabuar të Tvsh-së për barnat. Furnizimi i barnave ka qënë furnizim i tatueshem deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.182/2013 dt.28.12.2013 i cili ndryshonte Ligjin 7928, duke shtuar nenin 25/11 ku përcaktohej se nga dt.01.04.2014, furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore është furnizim i përjashtuar. Ky ndryshim nuk i kufizon efektet e tij vetëm për tatueshmërinë e shërbimit shëndetësor por reflektohet edhe në kreditimin e tvsh-se së paguar në blerjet e shoqërisë që i shërbejnë shërbimit shëndetësor.

Nga kontrolli i shpenzimeve të vitit 2013, është konstatuar se në zërin “*shërbime për konsulencë mjekësore*” janë përfshirë shërbime shëndetësore të ofruara nga mjekë individë në formën e një rekomandimi/diagnoze paraprake për spitalin lidhur me pacientë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për shumën **93.774.687 lekë**, pasqyruar në zërin shpenzime për shërbime dhe konsulencë mjekësore, shoqëria ka prerë çdo muaj nga një faturë tatimore “Faturë e lëshuar nga blerësi” dhe i ka bashkëlidhur listën emërore të mjekëve individë që kanë bërë rekomandimin/diagnozën për në spital lidhur me pacientin. I njëjti regjistrim kontabël dhe tatimor është konstatuar dhe në vitin 2014 për të njëjtat “shërbime për konsulencë mjekësore”. Sërish në këtë vit është kryer vlerësimi tatimor, ku shoqërisë nuk i janë njohur si të zbritshme shpenzimet e këtij zëri.

### **Vlerësimi i Gjykatës**

1- Sipas neni 33 pika 1 Ligji nr.7928 dt.27.04.1995 për TVSH-ne përcaktohet se e drejta e kreditimit perfitohet vetem nese furnizimet e bera jane per qellim te furnizimeve te tatueshme. Sipas Nenit 33 pika 4 furnizimi i barnave ka qene furnizim i tatueshem deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit nr.182/2013. Kjo dispozite e bën furnizimin e barnave dhe shërbimeve shëndetësore furnizim të përjashtuar. Ky ndryshim reflektohet dhe në kreditimin e tvsh-se së paguar në blerjet e shoqërisë. Nga momenti që shërbimi trajtohet si i përjashtuar shoqëria humbet të drejten e kreditimit të TVSH-se në blerje pasi këto blerje nuk i shërbejnë furnizimeve të tatueshme.

Kur aktivet kane nje vlere me te larte se 1,000,000 dhe perdorimi i tij ka ndryshuar brenda 5 viteve, shoqeria ka pasur detyrimin per te bere rregullimin e TVSH-se sipas formule se përcaktuar ne Udhëzimin nr.17 dt.13.05.2008 "Per Tvsh" Paragrafi 19.2. Aktivet i jane transferuar nje veprimtarie te përjashtuar pasi shërbimi shëndetësor ka ndryshuar tatueshmerine me dt.01.04.2014 dhe shoqeria duhet te kreditonte TVSH vetem ne ato vite ne te cilat ky aktiv i ka shërbyer veprimtarise se tatueshme.

### **2-Mosnjohja e Shpenzimeve për konsulencat mjekësore**

Sherbimi i konsulences duhet te ofrohet nga individe të cilët duhet të ishin të regjistruar në organet tatimore referuar VKM nr. 1058 datë 21.10.2009. Ky sherbim është ligjor për sa kohë është në përputhje me legjislacionin tatimor mbi regjistrimin dhe faturimin e shërbimeve të ofruara. Shërbimi i konsulencës mjekësore në faturat e shoqërisë nuk përcakton në mënyrë të imtësishme natyrën e sherbimit dhe si i tillë nuk mund te gjykohet se i sherben aktivitetit normal te saj. Konsulenca e ofruar nga mjeku nuk është e dokumentuar në kartela mjekësore apo ndonjë dokument tjetër. Rekomandimi /keshillimi i pacientit për tu drejtuar në një spital te caktuar nuk është i njohur nga ligjet fiskale dhe nuk është në shërbim të aktivitetit normal të shoqërisë.

### **Vendim**

1-Ndryshimin e Vendimit nr.5261 dt 09.11.2016 te Gj.Administrative të Shkallës së Parë  
2-Rrëzimin e kërkesë padisë të shoqërisë “A.H”

### **6. Vendim Nr.2359 Datë 12.09.2019**

**Paditës:** “Y” sh.pk

**I Paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë, pranë DPT Tiranë

### **Objekti:**

1. Shfuqizimin e aktit administrativ vendim Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_ Prot, datë 30.12.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë për dënimin me 1.000.000 (një milion) lekë gjobë dhe të Vendimit nr. \_ prot, datë 07.06.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.
2. Shfuqizim të aktit administrativ Proces Verbal Gjobë me nr. serie \_ datë 28.10.2015 i cili dënon tatimpaguesin “Y” me Nipt \_ me 1 000 000 lekë gjobë.

**Shuma e detyrimit tatimore:** 1000.000 lekë

### **Bazaligjore:**

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar përaktësisht Neni 80, 119, pika 1 gërma (a);
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 80.3 (c) 119/1 gërma (a);

3. Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në RSH-së” (i ndryshuar);
4. Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014;
5. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
6. Kodi i Procedurave Administrative.

### **Përmbledhje e Fakteve:**

Ndaj subjektit “Y” sh.p.k me Nipt \_ Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, pranë DRT Vlorë kanë ushtruar një kontroll në ambjentet e subjektit në bazë të Urdhërit të Punës me Nr. \_ Prot, datë 30.09.2015. Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërinë “Nikollaq Laska” sh.p.k është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial \_ datë 30.09.2015 ku rezultoi se: “...subjekti është i pajisur me Nipt K74615801N, në subjekt është instaluar pajisja fiskale, lëshon kupon tatimor, në subjekt punojnë pesë punonjës Znj. \_ID\_, Z. \_ID\_, Z. \_ID\_, Znj. \_ID\_, lista e cmimeve është afishuar në vend të dukshëm...”. Akt Konstatimi i mbajtur është përcjell për procedura të më tejshme në DRT Vlorë, është bërë verifikimi nga inspektori i dosjes në sistemin C@TS dhe ka rezultuar se punonjësit Z. \_ID\_ dhe Z. \_ID\_ nuk janë deklaruar në organin tatimor. Në bazë të Akt konstatimi të mbajtur është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobë me nr.serial \_ datë 28.10.2015, ku në bazë të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 119, pika 1 gërma (a), subjekti është penalizuar me gjobë në masën 1000.000 lekë për mos deklarim të dy punonjësve në organin tatimor. Për këtë penalitet subjekti është njoftuar nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr.\_Prot, datë 30.12.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata ka vlerësuar se procesi gjyqësor dhe dhënia e vendimit përfundimtar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë respekton normat e procesit të rregullt ligjor dhe nuk është konstatuar, qoftë edhe kryesisht, ndonjë shkelje e ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e procesit dhe/ose vendimit gjyqësor apo të tilla që të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit të ankimuar. Në përgjigje të pretendimeve të ngritura edhe në ankim nga paditësi, me të drejtë janë vlerësuar të pa bazuara në ligj e në prova. Nxjerrja e njoftim vlerësimit, akti i kundrshtuar në padi, për gjobë në vlerën 1,000.000 lekë për "Mosdeklarim punonjësi", është në përputhje me përgjegjësit ligjore të palës së paditur për kryerjen e veprimtarisë së saj sipas përcaktimeve të nenit 80 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 si dhe pikës 80.3 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008, i cili detajon verifikimin në vend si formë e kontrollit tatimor. Objekti i verifikimit për të ushtruar kontroll mbi zbatimin e nenit 119 të Lgjit nr. 9920 datë 19.05.2008 të ndryshuar është objekt i veprimtarisë të organeve tatimore. Sipas Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 "Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, në zbatim të këtij ligji organi tatimor vepron si agent tatimor për mbledhjen e kontributeve, ndaj përmbushja e detyrimeve për

deklarimin e punonjësve është objekt kontrolli dhe mbikqyrje nga pala e paditur, nën juridiksionin e të cilës ushtron veprimtarinë paditësi.

Paditësi rezulton të jetë ndëshkuar me gjobë në shumën prej 1.000.000 lekë mbi konstatimin e shkeljes administrative nga ana e inspektorëve tatimor të palës së paditur DRT Vlorë, pas kontrollit të ushtruar në vendin e ushtrimit të aktivitetit të paditësit, në fshatin Fitore, Komun Novosele, Vlorë, në zbatim të urdhrit të punës Nr. \_ Prot, datë 30.09.2015. Ka rezultuar e provuar se, gjendja e konstatuar është dokumentuar nga ana e inspektorëve në Akt-Konstatimin nr.serial \_ datë, 30.09.2015, ku citohen personat e gjetur në punë në vendin e ushtrimit të aktivitetit të paditësit. Akti i konstatimit është përcjellë për zbatim të mëtejshëm në DRT Vlorë, ku inspektori i dosjes ka bërë verifikimet e nevojshme nga ku ka rezultuar se dy punonjësit e konstatuar përkatësisht Jetnor Xhemaj dhe Geraldo Dinaj nuk rezultojnë të kenë qenë të përfshirë në skemen e sigurimeve me formularin E-Sig 027 në kohën në të cilën është mbajtur akt konstatimi, deklaruar nga subjekti në organin tatimor. Nga paditësi nuk kontestohet fakti i mësipërm.

Pretendimi i paditësit për pavlefshmëri të penaltetit të vendosur ndaj tij në shumën 500.000 lekë gjobë si masë ndëshkimore e paparashikuar nga ligji në momentin e nxjerrjes së aktit me të drejtë është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë i pabazuar. Pala e paditur DRT Vlore, në bazë të konstatimit të shkeljes administrative më datë 30.09.2015, ka proceduar me dënimin administrativ me gjobë të paditësit, në mbështetje të nenit 119 të Ligjit nr. 9920 datë 19.07.2008 i ndryshuar me Ligin Nr. 124/2012, dt.20.12.2012, botuar ne F.z. nr. 177, datë 09.01.2013. Pretendini i palës paditëse se masa e gjobës është vendosur në tejkalim të ligjit, duke pretenduar në menyre të gabuar se gjoba në shumën prej 500.000 lekë, sipas paditësit është miratuar me ndryshimet e bëra sipas ligjit nr. 99/2015 datë, 23.9.2015 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008,"*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar botuar me fletoren zyrtare nr. 187, datë 28 tetor 2015.

Në tërësi vlerësimi i bërë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë është në përputhje me ligjin, në përmbushje të detyrave funksionale të inpektorëve tatimor, ushtruar dhe dokumentuar në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit tatimor. Gjithashtu, nuk konstatohen arsye ligjore që bëjnë të cënueshëm Vendimin nr. 11095/1 prot, datë 05.01.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor për refuzimin e ankesës së paditësit.

**Vendim:** Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1602, datë 07.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Rrëzimin e Kërkesë Padisë.

## **7. Vendim Nr.1551 Datë 21.05.2019**

### **Gjykata Administrative Apelit Tiranë**

**Padites:** Shoqëria "X" sh.p.k.

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.  
Drejtoria e Apelimit Tatimor.

**Objekti:** Kundërshtimi dhe Shfuqizimi i “Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimor” nr..., datë 3.06.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 504,070 Lekë

**Baza Ligjore:**

1. Neni 109/2 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”;
2. Nenet 32, 153 e vijues të Kodit të Procedurës Civile;
3. Neni 7/a, 15/a, 17 e vijues të Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
4. Nenet 118 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative;
5. VKM nr.77, datë 28.01.2015.

**Përmbledhje e Fakteve:**

Pala paditëse, shoqëria “X” është person juridik i të drejtës tregtare shqiptare me formë ligjore të organizimit të saj, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e identifikuar me NIPT .., me zyrë qendrore të saj në Rrugën “Myslym Shyri”.

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: hapjen dhe drejtimin e qendrave e klinikave fizioterapike e rehabilitimi me dhe pa shtretër, tregtim me shumicë dhe pakicë të medikamenteve, aksesoreve farmaceutikë e parafarmaceutikë, produkte kozmetike, dietike e ortopedike, si dhe import dhe eksport mallrash të lejuara nga ligji.

...

Shtetësja BD është caktuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë të kryejë praktikën profesionale pranë shërbimit të Ortopedisë për periudhën 17.03.2015 deri në datë 17.06.2015.

Për shkak se shoqëria paditëse në këtë gjykim, nisur nga veprimtaria tregtare që ushtron, vepron si klinikë terapeutike, pranë saj është dërguar shtetasja B.D për ndjekjen e trajnimeve të veçanta, jo në mënyrë frekvente.

Gjithashtu në vërtetimin e datës 11.05.2015 të lëshuar nga Shërbimi Ortopedi Traumatologji pranë Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë, është pasqyruar se shtetësja B.D ka filluar praktikën për Fizioterapi në Shërbimin Ortopedi Traumatologji dhe pranë Klinikës private “XXX”, me NIPT, nga periudha 17.03.2015 deri në datë 17.06.2015.

Në zbatim të urdhërit të shërbimit nr.... prot., datë 11.05.2015, inspektorët e Hetimit Tatimor, Sektori i Zbatimit Tiranë, kanë ushtruar kontroll pranë subjektit “XXX” sh.p.k. dhe kanë mbajtur akt konstatimin nr serial .. datë 11.05.2015. Në përmbajtje të akt-konstatimit ndër të tjera thuhet se: *“...në punë u gjend B D e datëlindjes 15.08.1993, e cila u la të verifikohet në organin tatimor nëse është e deklaruar pasi nuk u paraqit listëpagesa”.*

Akt konstatimi i mësipërm i ka kaluar për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme DRT Tiranë, dhe kjo

e fundit, pasi ka bërë verifikimin në listëpagesat dhe në formularin E-sig 027 të shoqërisë, ka konkluduar se punonjësja e gjendur në momentin e kontrollit – shtetasja B D, ka qenë e padëklaruar në organet tatimore.

Si pasojë, shoqëria është penalizuar me gjobë në masën 500.000 lekë dhe është kryer rivlerësim tatimor për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, kjo bazuar në nenin 119, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”. Për këto detyrime, DRT Tiranë ka nxjerrë aktin administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrime Tatimore” nr... prot., datë 03.06.2015 me anë të të cilit tatimpaguesi është njoftuar për detyrimet për t’u paguar në një vlerë totale prej 504.070 lekë.

Njoftim Vlerësimin e mësipërm pala paditëse e ka ankimuar në Drejtorinë e Apelit Tatimor, e cila me Vendimin nr.... prot., datë 25.09.2015 ka vendosur: “Lënien në fuqi të Njoftim Vlerësimi”. Ndaj “Njoftim Vlerësimi” dhe Vendimit të DAT paditësi, shoqëria “XXX” sh.p.k. ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Në vlerësim të përcaktimit ligjor që jep neni 119 i ligjit 9920/2008, gjykata mban parasysh dy faktorë të rëndësishëm që cojnë në shkeljen e dispozitës së mësipërme, fakti i të qenit i punësuar pranë tatimpaguesit si dhe fakti i mosdeklarimit të tij në organet tatimore të paktën 24 orë përpara konstatimit. Në rastin konkret, rezulton se shtetasja B. D nuk ka qenë e punësuar pranë palës paditëse në kuptim të dispozitës së sipërcituar, por ka kryer një pjesë të praktikës profesionale për periudhën tre mujore (mars – qershor 2015) rezulton të jetë përmbushur pranë shërbimit të Ortopedisë – Traumatologjisë, fakt që konfirmohet nga vërtetimi i lëshuar nga Drejtuesi i Praktikantit pranë këtij shërbimi në QSUT.

Gjithashtu, të dy vërtetimet e paraqitura si provë në gjykim, konkretisht vërtetimi nr... prot., i datës 23.06.2015 i lëshuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë dhe vërtetimi i datës 11.05.2015 i lëshuar nga Shërbimi Ortopedi – Traumatologji pranë Qendrës Spitalore “Nënë Teresa” Tiranë, provojnë faktin se shtetasja B. D është regjistruar pranë Urdhërit të Infermierit të Shqipërisë me numër regjistri, si praktikante për zhvillimin e praktikës me mbikëqyrje si fizioterapiste pranë Spitalit të Traumës për periudhën nga data 17.03.2015 deri në datë 17.06.2015 dhe se për trajnime të veçanta dërgohet prej Urdhrit të Infermierit t’i ndjekë jo në mënyrë frekvente pranë klinikës “XXX”. Fakti që çertifikata e dhënë nga pala paditëse studentes praktikante përcakton specializimin e përdorimit të një prej teknikave terapeutike për 15 orë, konfirmon parcialitetin në kohë të ushtrimit të praktikës së studentes pranë palës paditëse.

Në situatën që kjo shtetase rezulton të jetë praktikante për zhvillimin e praktikës me mbikëqyrje si fizioterapiste pranë Spitalit të Traumës për periudhën nga data 17.03.2015 deri më datë 17.06.2015 si dhe për trajnime të vecanta dërgohet prej Urdhërit të Infermierëve t’i ndjekë jo në mënyrë frekvente pranë palës paditëse, në zbatim të VKM-së nr.77/2015, ajo duhet të sigurohet nga punëdhënësi, që në rastin konkret rezulton të jetë Spitali i Traumës (pranë të cilit B. D rezulton të jetë regjistruar si praktikante), vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur mes subjektit dhe institucionit përgjegjës.

Gjykata vlerëson se kundërvajtja e parashikuar nga neni 119, pika 1 e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008



“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk provohet të jetë kryer në kushtet kur shtetasja B.D. nuk ishte rregullisht e punësuar pranë palës paditëse, por praktikante pranë Spitalit të Traumas, i cili mbart dhe detyrimin për sigurimin nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për periudhën e praktikës, institucion me të cilin rezulton të ketë rënë dakord edhe Institucioni Përgjegjës i Praktikës – Urdhri i Infermierit.

Gjykata vlerëson se sipas nenit 35, pika 1 të ligjit 49/2012: “Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë”. Në rastin konkret, ushtrimi i kontrollit është kryer kryesisht nga organi tatimor, të cilit ligji i ngarkon barrën e provës dhe nga ana e tij nuk u provua që ky detyrim i ngarkuar subjektit paditës si tatimpagues, të ketë qenë i justifikuar në ligj dhe në prova. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e gjen të drejtë arsyetimin e mësipërm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në analizë të sa më sipër, gjykata vendosi:

### **Vendim:**

Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet” nr. prot., datë 03.06.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe të vendimit nr. datë 25.09.2015.

### **8. Vendim Nr. 468 Datë 07.10.2019**

#### **Gjykata Administrative e Shkalles se Parë Korçë**

**Padites:** Subjekti “S.M”

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

#### **Objekti:**

1. Shfuqizim i veprimeve procedurale te Drejtorise se Kontrollit Tatimor per kalimin e subjektit person fizik “S.M”ne subjekt me TVSH te njoftuar me shkresen Nr. \_ prot, date 27.05.2019
2. Shfuqizimin e vendimit Nr.\_ prot, date 13.06.2019 te Drejtorise se Apelimit Tatimor

#### **Shuma e detyrimit tatimor: Pa vlere**

#### **Baza Ligjore:**

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar;
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar;

3. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
4. VKM 953 date 29.12.2014

### **Përmbledhje e Fakteve:**

Bazuar ne te dhenat e deklaruar nga subjekti ne deklaraten e tatimit te thjeshtuar te fitimit per periudhen nga momenti i regjistrimit deri ne mbyllje te vitit ushtrimor 2018, subjekti rezultonte me te ardhura ne vleren 766.270 leke. Perllogaritja automatike e sistemit C@TS e tejkalon xhiron 2.000.000 leke duke bere edhe ndryshimet dhe kalimin me pergjegjesi tatimore te tvsh. Te gjitha ndryshimet i pasqyrohen subjektit on line ne llogarine personale te tatimeve. Tatimpaguesi i eshte drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor duke kundërshtuar ndryshimin e pergjegjesise tatimore, por bashkelidhur ankimit nuk eshte depozituar akti administrativ qe kundërshtohet.

### **Vlerësimi i Gjykates:**

Gjykata ne perfundim te gjykimit vendosi rezimin e padise, duke arsyetuar se shkresa Nr. 7074/1prot date 27.05.2019 njoftuar paditesit nuk eshte nje akt administrativ qe mund te kundërshtohet ne gjykate, ajo është një shkresë me të cilën DRT Korçë ka dhënë informacion DAT për mënyrën si ka kaluar paditesi në subjek me pergjegjesi tatimore te TVSH-së.

### **Vendim:**

-Rrëzimin e padisë në lidhje me ndryshimin e pergjegjesise tatimore të TVSH-së.

## **9. Vendim Nr. 42 Datë 04.02.2019**

### **Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korce**

**Padites :** Shoqëria “AA”

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatinore Korce

### **Objekti:**

1. Shfuqizimin e aktit njoftim vleresimit tatimor per detyrime Nr. \_ datë 25.01.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korce, ndaj tatimpaguesit lënë ne fuqi me Vendimin Nr. \_ datë 24.05.2019 te Drejtorise se Apelimit Tatimor
2. Fshirjen nga regjistrat e DRT Korcë të detyrimit që rjedh nga njoftim vlerësimi i lartpërmendur.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 164.700 leke

**Baza Ligjore:**

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42
2. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nenet 32, 40,45.
3. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

**Permbledhje e Fakteve:**

Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor ne daten 31.12.2018 është mbajtur akti i vlerësimit për subjektin “AA” pasi është konstatuar që subjekti ka kryer blerje tek subjekte me status pasiv. Konkretisht subjekti ka blerë produkte tek një tatimpagues i regjistruar me aktivitet tregetar fermer me status pasiv.

Pas mbajtjes fillimisht të aktit të vlerësimit është nxjerë njoftim vleresimi tatimor Nr.\_ datë 25.01.2019 ne vlerën totale 135.000 lekë tatim dhe 29.700 lekë gjobë.

**Vlersimi i Gjykates:**

Gjykata në përfundim të gjykit vendosi rrëzimin e padisë, gjykata vlereson se akti administrativ datës 15.01.2019 eshte nje akt i ligjshem dhe i vlefshem. Ky akt ka dalë në bazë të nenit 47, 68 dhe 115/1 te Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008.

**Vendim:**

- Lenia ne fuqi te aktit njoftim vleresimit tatimor per detyrime ne vlere totale 164.700 leke.

**10. Vendim Nr. 3301 Datë 19.12.2019****Gjykata Administrative e Apelit**

**Paditës:** Shoqëria "A" SH.P.K, NIPT \_

**I paditur:** l.-Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës.

**Objekti:**

Shfuqizimin si akt administrativ absolutisht i pavlefshem te Njoftim Vleresimit nr.\_, date 03.09.2015 sipas Raport-Kontrollit date 31.08.2015, derguar me shkrese nr.\_, date 03.09.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 41.530.062 lekë

**Baza Ligjore:**

1. Ligji nr. 9920 dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Nenet 23, 33, 38, 68, 73, 83, 84, 86, 109.
2. Kodi I Procedurës Civile, nenet 154 e vijues
3. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nenet 28 e vijues.
4. Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi procedurave Administrative në R.Sh", te Kodit të Proçedurave Administrative Nenet 116/c,117 e vijues.
5. Ligji nr.92/2014 dt.27.04.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", neni 76

### **Përmbledhje e Fakteve:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me Vendimin Nr.162 (474) Dt.22.02.2016, ka vendosur: "Rrezimin e padisë". Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim Shoqëria "A" shpk, me argumentet se: *"... gjate procesit te ushtrimit te kontrollit ndaj shoqerise, organi tatimor, qe ne niste te tij e deri ne pefundim te tij, me raportin e kontrollit dhe njoftim-vleresimin per detyrimet, ka kryer shkelje flagrante te ligjit. Kerkimi yne per pavlefshmeri absolute, te Njoftim vleresimit per detyrimet nr.\_ date 03.09.2015, bazohet ne shkeljen e rende, me procedurat dhe ne tejkallim te kufijve te percaktuara, te ligjit material nr.9920, date 19.05,2008, "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh.", i ndryshuar, ligjit nr.7928 date 27.04.1995 "Per-TVSH" i ndryshuar, dhe Udhezimeve te Ministrise se Financave ne zbatim te tyre, per te cilen cshte mbajtur edhe akti i kontrollit tatimor i dates 31.08.2015, i Drejtorise Rajonale Tatimore Durres. Akti administrativ duhet t'i referohet per çdo rast kërkesave të ligjit, me qëllim që të mos vijë në Kundërshtim me të, gjithashtu ai nuk duhet të tejkalojë për asnjë moment kufijtë e ligjit. Kundërligjshmëria e një akti administrativ është në ato raste, kur urdhërimet e tij nuk janë në përputhje me urdhërimet e ligjit, d.m.th. përmbajtja e aktit administrativ bie ndesh dhe nuk respekton përmbajtjen e vet ligjit. Kundërligjshmeri të tilla verehen, ne trajtimin e bere, persa i perket, detyrimeve qe jane nxjerre ne Njoftim vleresimin nr.\_, date 3.9.2015, sipas Raporti Kontrollit date 31.8.2015, qe vijne ne kundërshtim me urdherimet e ligjit ne nenet 73/1, te Ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh." i ndryshuar, ku ligji ka parashikuar te drejten e parashkrimit per te bere vleresime nga administrata tatimore, Neni 10/5 i ligjit nr.7928 date 27.04.1995 "Per TVSH", per lejimin e kreditimit te TVSH per objektet qe ndertohen per nevojat e aktivitetit, neni 83, pika 6, Ligjit 9920 date 19.5.2008, per te drejten e shqyrtimit nga grupi i kontrollit, i kundërshtimeve te projekt-raportit te kontrollit, te cilat jane shkelje flagrante te ligjit.*

*Pra, jemi ne kushtet e nenit 116, 117, te Kodit te Procedures Administrative, ku akti administrativ i Njoftim vleresimit nr.\_, date 3.9.2015, sipas Raport Kontrollit date 31.8.2015, është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe proçedurën e kërkuar nga ligji, dhe*

*si te tille, kemi nje akt absolutisht te pavlefshem, qe është i kundërligjshëm dhe pa vlerë juridike, e për rrjedhojë, nuk mund të krijojë pasoja juridike".*

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, referuar shkakut dhe objektit te kerkespadise, rezulton qe paditesi "A"sh.p.k, ta kete orientuar shqyrtimin gjyqesor, ne funksion te verifikimit te

elementeve te pavlefshmerise absolute te aktit objekt gjykimi, ne kuptim te Nenit 116/b,c te K.Pr.Administrative 1999, cituar me lart. Për të mbërritur ne kete perfundim, Gjykata Administrative e Apelit i referohet Vendimit Unifikues nr.3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se larte nëpërmjet të cilit është konkluduar se:

*“25.Kolegjet e Bashkuara të Gjykates së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesë padia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë.*

*26.1... Shkaku i padisë nuk duhet ngatërruar me të ashtuquajturën "bazë ligjore" apo referenca ligjore që ndeshet në kërkesëpadi.*

*26.2 Pra, dispozita ligjore nuk është shkaku i padisë, pasi ky i fundit identifikohet duke e parë të lidhur me faktet e pretenduara që kanë çënuar të drejtën subjektive apo interesat e ligjshme të paditësit.*

*27.Në jo pak raste në praktikë "baza ligjore" e padisë, e cila shënohet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë, barazohet me shkakun e padisë, ç'ka është e pasaktë. Baza ligjore në këtë rast është vetëm një nga elementet që shërben për të identifikuar të drejtën subjektive që paditësi kërkon të mbroje në gjykatë”*

Perfundimisht Gjykata e Apelit Administrativ e vlereson korrekt perfundimin e Gjykates Administrative të Shkalles se Pare Durrës, lidhur me mungesen e elementeve qe sjellin pavlefshmerine absolute të akteve objekt gjykimi.

#### **Vendim:**

Lënien në fuqi të vendimit Nr. 162 (474), date 22.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës.

### **11. Vendim Nr. 1941 Datë 20.06.2019**

#### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria "B" Sh.p.k,

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës.

#### **Objekti:**

Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Nr.\_ Prot, datë 26.08.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 500.000 lekë.

## **Baza Ligjore:**

1- Nenet 33, 38, 109, 119 e vijues të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

2-Nenet 154 e vijues të Kodit të Proçedurave Civile. Ligji 49/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative"

**Përmbledhje e Fakteve:** Në datë 30.07.2015, inspektorët e verifikimit ne terren, prane Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, rezultojnë të kenë ushtruar kontroll në ambientin e aktivitetit të tatimpaguesit "B" sh.p.k. Në përfundim të kontrollit është konstatuar mosdeklarim në organet tatimore i punonjësës Znj.\_. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës ka disponuar Njoftim Vlerësimin Nr.\_ Prot, Dt.26.08.2015, që konsiston në ngarkim të tatimpaguesit, me vlerë 500.000 lekë gjobë, për mosdeklarim punonjësi. Pas ushtrimit të ankimit administrative, DAT me vendimin Nr.\_ Prot, datë 25.11.2015 ka vendosur lënien në fuqi të Njoftim Vlerësimit

.Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Vendimin Nr.174 Dt.25.02.2016, ka vendosur: "Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. Shfuqizimin e Aktit Administrativ të Njoftim Vlerësimit për detyrimet Nr.\_, datë 26.08.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës për gjobën në shumën 490.000 lekë. Lënien në fuqi të Aktit Administrativ të Njoftim Vlerësimit për detyrimet Nr.\_, datë 26.08.2015, për gjobën në shumën 10.000 lekë". Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim pala e paditur me pretendimet se:

Vendimi nuk gjendet i bazuar në ligj dhe në prova. Sanksioni administrative I është komunikuar kundravajtësit me aktin administrative Njoftim Vlerësimin Nr.\_, datë.26.08.2015 në vlerën 500.000 lekë, për punonjës të padeklaruar, konkretisht shtetases Znj.\_, referuar nenit 119/1 gërma (a), të ligjit 9920, datë19.05.2008. Akte e konstatimi janë firmosur nga administrator I saj pa asnjë kundërshtim. Punonjësja Znj\_ është deklaruar pranë organeve tatimore në ditën e kryerjes së kontrollit.

Gjykata në interpretimin e saj, ka keqinterpretuar ligjin duke, reduktuar penaltetin e vendosur nga 500.000 lekë në 10.000 lekë, duke iu referuar nenit 119, pika 2 të ligjit 9920, dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH". Pala paditëse nuk provon në asnjë rast se akti administrative është në kundërshtim me ligjin. Pretendimet e paraqitura nga pala paditëse nuk përmbajnë argument bindës për t'u pranuar nga gjykata.

**Vlerësimi i Gjykatës:** Gjykata Administrative e Apelit, gjate shqyrtimit të çështjes ka konkluduar se:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka gabuar në interpretimin e dispozitave ligjore në zgjidhjen e çështjes. Rezultojnë se deklarimi I punonjësës Antea Grami është deklaruar ditën që është mbajtur akt konstatimi. Nga ana e tatimpaguesit nuk është provuar dhe argumentuar ligjërisht se vlerësimi tatimor është i pasaktë.

Referuar të dhënave në aktin e konstatimit dhe verifikuar në sistemin C@TS, punonjësi ( Znj.), është deklaruar pranë organeve tatimore, me formularin E-SIG 027/a, NË DATËN 30.07.2015. me datë fillimi pune në datën 30.07.2015, pra ditën e kryerjes së kontrollit dhe verifikimit në vend. Ligji 9136, datë 11.09.2003 “ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.23, datë 09.12.2014, në zbatim të këtij ligji, cdo tatimpagues është i detyruar të deklarojë në organet tatimore, në afatin e përcaktuar cdo punëmarrës, me anë të formularit E-SIG 027/a “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë atyre rishtazi dhe të larguarve nga puna” Referuar datës së konstatimit, mosdeklarimin i punëmarrësve në organin tatimor, të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës përbën shkelje tatimore administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 119 të ligjit Nr.9920, datë.19.02.2008 “ Për Procedurat Tatimore në R.SH” Vlerësimi me gjobë 500.000 lekë konsiderohet i drejtë 500.000 lekë.

**Vendim:**

- Ndryshimi ne vendimit Nr.174 (252) Dt.25.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
- Rrëzimin e kërkesëpadisë.
- Kundër vendimit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë

## **Pavlefshmëria absolute**

### **12. Vendim Nr. 1963 Datë 20.06.2019**

#### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria "XX" Sh.p.k, Nipt J61821522E

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore, Durrës.

**Objekti:** - Konstatimi i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, Vendim Nr. \_\_, datë 02.06.2015 të DRT Durrës.

-Sigurimin e padisë, pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendim Nr. \_\_, datë 02.06.2015 të DRT Durrës, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 46.152.074 lekë.

#### **Baza Ligjore:**

1. Kodit të Proçedurës Civile, neni 609
2. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 7, 15, 17/a, 28 e 30.

**Përmbledhje e Fakteve:** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Vendimin Nr.17 (82-2016-35), Dt.18.01.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e Padisë si të pabazuar në Ligj”. Shpenzimet gjyqësore sit ë jenë kryer. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë brenda 5 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në datë 26.02.2014, nga DRT Durrës është ushtruar kontroll tematik, në subjektin tatimpagues “XX” sh.p.k, në zbatim të Njoftimit të Kontrollit dërguar paditësit me shkresën Nr.2693/10 Prot, datë 06.03.2015. Në përfundim të kontrollit është mbajtur Raport Kontrolli datë 17.04.2015, i cili i është komunikuar paditësit nëpërmjet shkresës Nr. \_\_Prot, Dt.29.04.2015. Pas marrjes dijeni subjekti k paraqitur kundërshtimet lidhur me konkluzionet e raportit dhe inspektori I kontrollit, më datë 29.05.2015 ka nxjerrë raportin përfundimtar të kontrollit. Bazuar në konkluzionet e Raportit Përfundimtar të Kontrollit, datë 29.05.2015, DRT Durrës i ka dërguar subjektit “XX” Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. \_\_, datë 02.06.2015. Subjekti “XX” ka paraqitur ankim administrative në DAT, e cila me vendimin nr. \_\_, datë 18.09.2015 ka vendosur: “Refuzimin e ankimit për shkak se ankimit nuk i është bashkëngjitur akti administrativ i kundërshtuar.

Kundër këtij Vendimi ka paraqituri Ankim pala paditëse me pretendimet se:

- Për shkak të mospranimit të ankimit nga instancat ankimore administrative, akti administrativ i ankimuar është bërë titull ekzekutiv dhe jo vetëm kaq por ka filluar të vihet në ekzekutim.
- Subjekti XX shpk, nga viti 2012 nuk ushtron më aktivitet për arsyet e veta, por inspektorit i janë



vënë në dispozicion materiali që gjendej I arshivuar pranë një zyre të paditësit, pasi një pjesë e mirë e dokumentacionit nga ish ambjentet e punë në Romanat, janë transferuar në disa ambjentë të tjera pasi siç shpjegoam kjo shoqëri nuk ushtron më aktivitet. Një pjesë e dokumentacionit është i reflektuar në bilance e libra shitjeje e blerjeje, por edhe një pjesë e mirë ka qënë në dispozicion të inspektorëve, pasi nuk ka kuptim sit ë jenë përmendur e parovuar prej tyre në një pjesë të akt kontrollit, ndërsa në pretendimet e tyre të pretendohet se mungojnë.

-Veprimi i punonjësve është në kundërshtim me ligjin, pasi nuk mund të nxirrin Akt Njoftim Vlerësimin, pa shqyrtuar gjithë dokumentacionin e paditësit. Gjithashtu në kërkesë padi është parashtruar se në kërkojmë nga Gjykata një ekspert, Gjykata nuk e mori në konsideratë këtë kërkim, duke refuzuar e për më tepër nuk pranoi për shqyrtim as një ekspertizë të depozituar nga paditësi, nën pretendimin se duhej të ishte bërë në veprime përgatitore, por dhe nën paragjykimin se nuk jemi para titullit ekzekutiv e padia do të rrëzohej.

-Duke pretenduar se kemi para një titulli ekzekutiv sipas 609 të KPC, Gjykata nuk duhej të nxirrte konkluzionin se Akt Njoftim Vlerësimi Tatimor, nuk qënka titull ekzekutiv, por vetëm akt administrative.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit, gjate shqyrtimit të çështjes ka konkluduar se: Vendimi Nr.17, datë 18.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duhet të lihet në fuqi, si një vendim i drejtë, i mbështetur në prova dhe në ligj.

Me vendimin Nr.3, datë 29.03.2019 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë arritur në përfundimin se “Për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës.Gjykata Administrative e Apelit evidenton se paditësi, ka pretenduar se shkak për lindjen e mosmarrëveshjes është nxjerrja nga ana e DRT Durrës “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” Nr.\_\_, datë 02.06.2015 në kundërshtim me ligjin e për pasojë pretendon që gjykata ta konsidrojë atë si të pavlefshëm, duke e konsideruar atë si një titull ekzekutiv. Gjykata evidenton se pala paditëse nuk ka referuar në ekzistencën e kushteve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrative, por ngre pretendime që kanë të bëjnë me ligjshmërine e aktit administativ.

Padia ndaj veprimit administrative mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrative, shterim i cili në rastin konkret nuk rezulton të jetë ezauruar nga pala paditëse, për aq kohë sa DAT, nuk e ka marrë në shqyrtim ankimin administativ të palës paditëse. Kërkesa për kryerjen e aktit të ekspertimit, nuk është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, pasi kjo kërkesë kishte të bënte me pretendimet mbi themelin e aktit administrative.

### **Vendim:**

- Lënien në fuqi të vendimit Nr.17, Dt.18.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të tij.

### **13. Vendim Nr.2596 Datë 3.10.2019**

#### **Gjykata Administrative Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria AAA sh.a

**I paditur:** Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj

**Objekti:** Pavlefshmeri absolute e njoftim vleresimit nr. 13582/23, dt. 25.11.2016 dhe nr. 13582/25, dt.2.12.2016

**Shuma e detyrimit tatimor:** 759.585.881

#### **Baza Ligjore:**

1. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
2. Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

#### **Permbledhje e Fakteve:**

Paditesi ka qene subjekt i një kontrolli të ushtruar nga DTM mbi bazën e të cilit ka dalë njoftim vlerësimi nr. \_\_, dt.25.11.2016 dhe nr. \_\_, dt.2.12.2016 për detyrimin tatimor në shumën 645.139.866 leke dhe 114.446.015 leke qe perbehet nga tatim fitimi, takse karboni, TVSH dhe gjobe. Paditesi kërkon konstatimin e pavlefshmerise absolute te ketyre akteve per shkelje te procedures se nxjerrjes se tyre.

#### **Vlerësimi i Gjykates:**

Gjykata vlerëson se veprimtaria e organeve tatimore rregullohet nga ligjet materiale të fushes , konkretisht ligji 9920 dhe udhezimi nr. 24 ne zbatim te tij.Gjykata ne arsyetimin e vendimit I referohet nenit 68, pika 1 germa a dhe pika 5 germa b te ligjit 9920/2008, pikes 68.3.1, pikes 70.1 dhe 70.2 te Udhezimit nr. 24/2008 duke arsyetuar se detyrimet e subjektit jane rezultat I fakteve te konstatuara ne perfundim te kontrollit tatimor, materializuar ne aktin administrativ njoftim vleresimi qe nxjerr drejtoria rajonale tatimore , I ankimueshem ne rruge administrative e gjyqesore. Gjykata merr ne analize nenin 108 te KPA per rastet e pavlefshmerise absolute te akteve administrative dhe konstaton se procedura e nxjerrjes se akteve objekt gjykimi eshte ndjekur ne menyre rigoroze referuar kjo procedures se ushtrimit te kontrollit te percaktuar ne ligjin 9920. Nga

teresia e veprimtarise administrative ne nxjerrjen e akteve, Gjykata vlereson se DTM ka respektuar standartet e procesit te rregullt ligjor qe te shpie ne perfundimin se aktet objekt gjykimi jane ne perputhje me ligjin.

Vendim:

- Lënia në fuqi e aktit administrative.

#### **14. Vendim Nr. 2935, Datë 07.11.2019**

#### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “Y” sh.p.k,

**I paditur:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë  
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

#### **Objekti:**

1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_ prot, datë 20.11.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ vendimi nr.\_ prot datë 22.02.2016 i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**Shuma e detyrimit:** 500 000 lekë

#### **Baza ligjore:**

1. Ligji nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 119, pika 1, gërma (a)

#### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Shoqëria “Y” sh.p.k është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, me numër Nipti \_\_, me objekt aktiviteti “rrobaqepësi për qepje konfeksione, në fushën e përpunimit aktiv të konfeksioneve ...”

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.\_\_ prot datë 20.11.2015, dënim për “punonjës të padeklaruar në organin tatimor” në vlerën 500 000 lekë, bazuar në nenin 119.1.a të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar me shkresën nr. \_ prot datë 22.02.2016 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos:

- *Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit të D.R.T-ve Shkodër dhe rrëzimin e ankimit.*

Fillimisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është adresuar për gjykim çështja me palë paditëse subjektin Shoqëria “Saandr” sh.p.k, palë e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, dhe me objekt gjykimi sipas kërkesë-padisë së komunikuar nga gjykata

*1.Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ “njoftim vlerësimi për detyrime tatimore” nr. \_prot, datë 20.11.2015 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.*

*2. Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ vendimi nr.\_ prot, datë 22.02.2016 i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë*

*3. Shpenzimet gjyqësore.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në lidhje me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.737 (895) datë 07.11.2017 nëpërmjet të cilit vendosi:

*Kthimin e kërkesë-padisë. (Vendim i formës së prerë datë 01.12.2017)*

- Subjekti i drejtohet gjykatës në vijim sipas objektit të kërimit sa më lart shprehur në pjesën hyrëse.

Grupi i punës së kontrollit tatimor në zbatim të detyrave funksionale ka ushtruar kontroll, në bazë të Urdhrit të punës nr.439 prot, nr.38 prot datë 19.01.2015 pranë ambjenteve të ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë “Y” sh.p.k, me numër Nipti \_\_, në adresën Lagj : “Skenderbeg” dhe ka mbajtur Akt konstatimin me numër serie \_\_, \_\_ të 19.01.2015 në të cilin ka pasqyruar faktet e konstatuara.

Në Akt konstatim është pasqyruar gjendja e konstatuar në fakt në momentin e kontrollit.

Referuar përmbajtjes së Akt konstatimit me numër serie \_\_, \_\_ datë 19.01.2015 citohet :

“I mbajtur sot me datë 19.01.2015 në Shkodër nga \_\_\_\_\_, ndaj tatimpaguesit Y sh.p.k, me Nipt \_\_, adresë Lagj “Skenderbeg”, veprimtari ekonomike “fason”, i përfaqësuar nga z.X me dokument identifikimi pasaportë \_\_, ku është konstatuar se :

- *Në zbatim të Urdhrit të punës nr.439 datë 19.01.2015 dhe nr.38 të Hetimit u krye verifikimi ku rezultoi :*

*1.Subjekti është i rregjistruar në Q.K.R me \_\_\_\_.*

*2.Në punë u gjetën :*

*1 .Z. \_\_\_\_\_ - 19. Z. \_\_\_\_\_*

Referuar Akt konstatimit në rubrikën “Për tatimpaguesin” evidentohet shënimi përkatës nga subjekti, i cili konsiston “Nuk jam dakort me emrin e personit Z.\_\_\_\_ sepse kam tentuar ta hedh në sistem, por sistemi s’ka funksionuar”.

Rezulton se shënimi është lënë për Z.\_\_\_\_ dhe nuk ka pasur objeksione për \_\_\_\_\_ për të cilin në vijim është bërë vlerësimi nga organi tatimor.

Me shkresën nr.\_\_\_\_ prot datë 24.03.2015 Drejtoria e Kontrollit, Sektori i Verifikimit në Terren ka kaluar për verifikim të mëtejshëm praktikën pranë Drejtorisë së Vlerësimit në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe në vijim është vlerësuar praktika është bërë verifikimi i punonjësve të deklaruar si “të punësuar” nga Shoqëria “Y” sh.p.k para organit tatimor, detyrim ligjor ky për të, referuar të dhënave të aktit të konstatimit, punonjësve të konstatuar në punë në momentin e kontrollit, hetimit të bërë.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se punonjësi i gjendur në punë \_\_\_\_ nuk është deklaruar në organin tatimor, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër konform rregullave dhe afateve të përcaktuara ligjore.

Pra mbi bazën e informacionit të marrë nga aktet e kontrollit është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si “të punësuar” nga subjekti para organit tatimor, për periudhën tatimore lidhur me konstatimin e bërë, detyrim ligjor ky për të dhe nëse deklarimi i këtyre punonjësve është bërë konform kërkesave ligjore.

Është paraqitur para Gjykatës me vlerën e provës Deklaratë, “Listëpagesë e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” për periudhën tatimore janar/2015, deklaruar nga subjekti para organit tatimor, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, detyrim ky i tij ligjor në formën dhe mënyrën e kërkuar nga ligji ku evidentohet, se nuk rezulton i përfshirë punonjësi Z.\_\_\_\_ i gjendur në punë ditën e konstatimit të bërë datë 19.01.2015.

Nga D.R.T-ve Shkodër referuar konstatimit të bërë dhe pasqyruar të dhënat mbi gjendjen e faktit në akt konstatimin e sipërpërmendur është mbajtur dhe Akt dënimi nr.\_\_\_\_ prot datë 13.11.2015, sipas të cilit subjekti është sanksionuar me një gjobë në vlerën 500 000 lekë për “punonjës të padeklaruar” para organit tatimor, bazuar në nenin 119.1.a të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Subjekti është vlerësuar me gjobë sa më lart shprehur sipas Akt dënimit nr.\_\_\_\_ prot datë 13.11.2015 dhe në vijim njoftim vlerësimin tatimor objekt gjykimi.

Vlerësimi i gjobës është bërë bazuar në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për proçedurat tatimore në RSH-së”, i ndryshuar, **neni 119, pika 1, gërma (a).**

#### **Arsyetimi ligjor i gjykatës :**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin saj nr.760 datë 06.11.2018 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë-padisë së palës paditëse

- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ “njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” nr. \_\_ prot datë 20.11.2015 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ vendimi nr. \_\_ prot datë 22.02.2016, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë .....*

Mbi bazën e ankimit të D.R.T-ve Shkodër çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin Nr.2935 datë 07.11.2019 vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.760 datë 06.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Kundër këtij vendimi nuk lejohet Rekurs.*

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se vendimi nr.760 datë 06.11.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është i bazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Në datën 19.01.2015 është ushtruar kontroll nga ana e inspektoreve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe është mbajtur Akt konstatimi me nr.serie \_\_ datë 19.01.2015. Gjithashtu dhe në datën 15.09.2015 nga inspektorët tatimor të D.R.T-ve Shkodër është ri-ushtruar kontroll duke mbajtur akt konstatimin me nr.serie \_\_ datë 15.09.2015.

Në vijim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër me aktin administrativ njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. \_\_ prot., datë 20.11.2015 ka penalizuar subjektin me 500.000 leke gjore për arsye të “mosdeklarimit të punonjesit” sipas nenit 119 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se me të drejte gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, se në rastin konkret aktet administrative të palës së paditur përmbajnë shkaqe të pavlefshmërisë absolute siç pretendon pala paditëse shoqëria “Y” sh.p.k.

Neni 119 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” përcakton se :

“1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor gdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura nga data e konstatimit denohet me gjore për çdo punonjes të padëklaruar :

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjore prej 500 000 (peseqind mijë) lekesh

b) tatimpaguesit e tjerë me gjore prej 50 000 (pesedhjetë mijë) lekesh”

Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar për zbatimin e këtij ligji pika 119 “Mosdeklarim i të punësuarve” shpreh se:

“Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënesin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Te gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë ne organin tatimor perkates te punesuarit (perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes se personit fizik me te cilet ai punon e bashkejton ligjerisht) qe fillojne pune per here te pare te subjekti apo te punesuar rishtazi prane tij me te dhenat e kerkuara per secilin prej tyre. Ky deklarim duhet te behet te pakten nje dite kalendarike perpara fillim it te punes se te punesuarve”.

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se ne rastin objekt gjykimi aktet administrative te kundershutuara nga pala paditese jane absolutisht te pavlefshme sipas percaktimeve te nenit 116 te K.Pr Administrative. Neni 116 i K.Pr. Administrative percakton se :

“Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, ne rastet e meposhtme :

- a) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i paidentifikuar
- b) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore
- c) kur akti eshte nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji”

Në rastin konkret rezultoi, se njoftim vlerësimi per detyrimet tatimore nr.\_\_\_\_ datë 20.11.2015 mbajtur nga D.R.T Shkoder mbi bazen e akt konstatimit me nr.serie \_\_\_\_ date 19.01.2015 rezulton te jete ne kushtet e pavlefshmerise absolute te aktit, per shkak të procedurës dhe mënyrës së mbajtjes së akt konstatimit dhe se referuar vetë përmbajtjes së akt konstatimit citohet se :

“në zbatim të urdhrin të punës nr.\_\_\_\_ datë 19.01.2015 dhe nr\_\_\_\_ prot., të Hetimit është kryer verifikimi ku rezulton :

1. Subjekti eshte i regjistruar ne QKR... Në punë u gjetën :

1. \_\_\_\_ -19.\_\_\_\_

Sipas përmbajtjes së akt konstatimit nr.\_\_\_\_ date 19.01.2015 vërehet, se ky akt nuk është mbajtur në formën e parashikuar nga ligji. Sipas tij rezulton të jetë bërë përshkrimi i punonjësve në emër dhe mbiemër, por të paidentifikuar me kartë identiteti dhe kjo për Gjykatën bie në kundërshtim me ligjin. Identifikimi i punonjësve nuk mund të bëhet nëpërmjet pyetjes së emrit dhe mbiemrit të tyre, por duhet të verifikohet deklarimi i çdo punonjësi me ID që mban një numër personal, numër me të cilin rregjistrohen punonjesit në listat e sigurimeve shoqërore. Ky fakt është i rëndësishem për vlefshmërinë e përmbajtjes së vetë aktit administrativ, aktit të konstatimit nr.serie \_\_\_\_ date 19.01.2015, pasi nëse çdo punonjësi i përshkruar në akt me emër dhe mbiemër do të ishte plotësuar me ID e tij, pasaktësia e përshkrimit nuk do te ekzistonte dhe nuk do linte hapësire ligjore për të ngritur pretendime nga tatimpaguesi. Gjithashtu referuar listepagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të depozituar si prova gjatë gjykimit në shkallë të parë nga pala paditese rezulton, se nuk ka punëmarrës Z.\_\_\_\_ sipas përshkrimit të administratës tatimore në aktin e konstatimit datë 19.01.2015, por Zj.\_\_\_\_ me ID nr.\_\_\_\_. Në këtë kuptim referuar sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit arriti në konkluzionin se aktet

administrative objekt gjykimi janë nxjerrë nga pala e paditur në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar dhe Udhëzimi i Ministrit te Financave nr.24, date 02.09.2008 “Per procedurat tatimore”. Gjithashtu sipas gjykatës mbi bazën e provave të paraqitura nga pala paditëse konstatohet, se vetë pala e paditur rezulton të ketë mbajtur dy akte konstatimi ai i dates 19.01.2015, ku rezulton të mos jene identifikuar punonjesit me numrin personal te tyre dhe ai i datës 15.09.2015 në përmbajtje të të cilit rezulton të jetë shënuar numri i personal ID për çdo punonjës.

Në këtë kuptim Gjykata Administrative e Apelit çmon, se identifikimi i punonjesve sipas numrit personal ID është një detyrim ligjor i palës së paditur, pasi nëpërmjet këtij numri pala e paditur mund të bëjë verifikimet për deklaratimet që bën shoqëria në organet tatimore dhe sigurimeve shoqërore në lidhje me deklaratimet e punonjësve. Pretendimi i palës së paditur i paraqitur në ankimin e saj përpara Gjykatës, se akti i konstatimit është mbajtur prej grupit të kontrollit tatimor, i cili provon shkeljen e konstatuar është një pretendim i pabazuar në ligj e në prova. Rezulton nga aktet e paraqitura gjatë gjykimit të çështjes se aktet e palës së paditur janë në kundërshtim flagrant me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, siç me të drejtë ka vlerësuar Gjykata e Shkallës së Parë. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se masa administrative e vendosur ndaj subjektit “Y” sh.p.k “Mosdeklarim te punonjesi” sipas nenit 119 te ligjit nr.9920/2008 ka dalë në kundërshtim me procedurat e mbajtjes së akt konstatimit datë 19.01.2015 duke sjelle keshtu pavlefshmerinë absolute te njoftim vleresimi per detyrimet tatimore nr. \_\_ prot, datë 20.11.2015 të Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder, i lënë në fuqi me vendimin nr. \_\_ prot, datë 22.02.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

### **Vendimi i Gjykatës:**

Gj.Ad.A me vendimin Nr.2935 datë 07.11.2019 vendosi:

*Lënie në fuqi të vendimit nr.760 datë 06.11.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Kundër këtij vendimi nuk lejohet Rekurs.*

➤ Grupi i punës së Kontrollit tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në zbatim të Urdhrit të punës nr.... prot datë 09.09.2015 ka ushtruar kontroll në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë “AAA” sh.p.k, me numër Nipti , në adresën ..., me objekt aktiviteti “tregtim karburanti, bar-restorant.. , hotel ...” dhe ka mbajtur Akt konstatimin me numër serie ... datë 09.09.2015.

Në Akt konstatim është pasqyruar gjendja e konstatuar në fakt në momentin e kontrollit.

*Referuar përmbajtjes së Akt konstatimit, citojmë :*

*“Në bazë të Urdhrit të punës nr... datë 09.09.2015 u konstatua :*

- *Subjekti është rregjistruar në Q.K.R*
- *Në momentin e kontrollit u gjetën në punë 1) MH me Numër Karte ; 2) S R me numër Karte D; 3) L Ç me numër Karte; 4) BK me numër Karte.*
- *Kasa është e instaluar dhe transmeton*
- *Lëshon kupon tatimor*



- ..... ”

Një kopje e Akt konstatimit i është lënë për njohje subjektit, në rubrikën “Për tatimpaguesin” ka nënshkruar njëri nga punonjësit e gjendur në punë, Zj.MH.

▪ Nga grupi i kontrollit tatimor është mbajtur Proçesverbali i gjobës me numër serie .... datë 11.09.2015 sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë në vlerën 500 000 lekë për “punonjës të padeklaruar” para organit tatimor.

Nga kontrolli tatimor është bërë verifikimi në Sistemin informatik tatimor, pranë D.R.T-ve Shkodër i të gjithë punonjësve të deklaruar si “të punësuar” nga subjekti para organit tatimor deri në atë kohë, pasi dhe “përfaqësuesi i subjektit” gjatë komunikimit në momentin e kontrollit ka pasur pretendime, se personin në fjalë e ka deklaruar para organit tatimor.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se ndër punonjësit e gjendur në punë ditën e konstatimit nuk është deklaruar në organin tatimor konform rregullave dhe afateve të përcaktuara ligjore punonjësi L Ç (pasqyruar dhe në Proçesverbalin e gjobës me numër serie..... datë 11.09.2015), ai rezultonte i padeklaruar.

Referuar Proçesverbalit të gjobës me numër serie ... datë 11.09.2015 shprehet :

“Në bazë të Akt konstatimit me nr..... datë 09.09.2015 rezulton, se punonjësi LÇ nuk ishte i siguruar”.

Subjekti paditës, punonjësin e gjendur në punë ditën e konstatimit z.LÇ e ka deklaruar si të punësuar më vonë në **datën 12.09.2015, me datë fillimi pune 04.08.2015**, pra pas kryerjes së konstatimit. (është paraqitur para gjykatës me vlerën e provës Deklarata “E-Sig – Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi si dhe e të larguarve nga puna Nr. datë 12.09.2015”, deklarim i vetë subjektit, e cila pasqyron këtë fakt).

Për këtë arsye subjekti është vlerësuar me gjobë në vlerën 500.000 lekë sipas Proçesverbalit të gjobës dhe në vijim njoftim vlerësimit tatimor për punonjës të konstatuar të padeklaruar pranë organit tatimor. Akti i Proçesverbalit të gjobës i është komunikuar subjektit, në rubrikën “Për tatimpaguesin” nga grupi i kontrollit tatimor (rezulton të jetë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të kontrollit për të konfirmuar këtë moment) është lënë shënimi “Refuzon”, firmën.

Vlerësimi i gjobës është bërë bazuar në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së” i ndryshuar, **neni 119, pika 1, gërma (a).**

### **Vlerësimi i Gjykatës :**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin saj nr.410 datë 03.06.2016 ka vendosur :

- Pranimin e kërkesë-padisë
- Anullimin e njoftim vlerësimit detyrim tatimor nr... prot datë 09.10.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër si dhe vendimit nr.... prot datë 18.12.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë
- Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës së paditur.

Mbi bazën e ankimimit të D.R.T-ve Shkodër çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

Gj.Ad.A me vendimin Nr.1514 datë 16.05.2019 vendosi :

- *Ndryshimin e vendimit nr.410 datë 03.06.2016 të Gj.Ad.Sh.P.Shkodër në këtë mënyrë:*
- *Rrëzimin e padisë*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit*
- .....

Gjykata çmon se:

Mosdeklarimi i punonjësve në organin tatimor, përbën shkelje administrative dhe penalizohet me gjobë, sipas nenit 119 paragrafi i parë gërma “a” i ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjykata cmon, se Akti i konstatimit i mbajtur prej grupit të kontrollit tatimor, provon shkeljen e konstatuar. Akti është mbajtur nga persona zyrtare, përgjate kryerjes së detyrës së tyre dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, që ka për qëllim të dokumentojë veprimet e kryera prej tyre dhe ngjarje të ndodhura në prani të tyre, i përpiluar në formën e kërkuar nga ligji.

Në lidhje me pretendimin e palës paditëse, se nuk ka funksionur sistemi për të bere deklarimin on-line Gjykata cmon se :

Së pari: Referuar faqes nr.2 të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë rezulton, se kjo e fundit shprehet ndër të tjera dhe në lidhje me "pretendimet e subjektit", shprehur në kërkesën e tij ankimore, adresuar kësaj instance të shqyrtimit të çështjes në rrugë administrative. “Kemi llogaritur dhe paguar sigurime për muajin gusht 2015 dhe kaluar dhe pagën përkatëse... por nga verifikimi që është kryer në sistem del, që nuk është deklaruar si pasojë e harresës së ekonomistës sonë. Gjithë dokumentacioni i servirur nga ana jonë shpreh, se ne e kemi legalizuar këtë punonjës, pavarësisht mungesës së deklarimit. Mendojmë se është një rast fatkeq që duhet marrë në konsideratë për faljen e gjobës”.

Pra në ankimin administrativ vetë paditësi ka pranuar, se pagesa e vonuar është bërë për shkak të harresës dhe jo për shkak të mosfunksionimit të sistemit.

Së dyti: Nuk ka asnjë prove që të provojë pretendimin e paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e ka marrë të mirëqenë këtë pretendim me argumentin se këtë duhet ta provonte pala e paditur. Ky argument është i pabazuar në ligj. Pala e paditur ka detyrim të provojë bazueshmërinë në ligj të aktit të nxjerre prej saj, njoftim vleresimit tatimor dhe këtë e provon me Akt konstatimin e mbajtur prej grupit të kontrollit tatimor dhe procesverbalin të dalë në bazë të këtij akt konstatimi. Nëse pala paditëse tanime ka një pretendim për mosfunksionim sistemi ajo duhet ta provojë këtë gjë. Por edhe sikur ta pranojmë që sistemi nuk paska funksionuar, përsëri pala paditëse nuk provon ta ketë njoftuar për këtë organin tatimor ose të paktën të kishte dorëzuar deklaratën e kërkuar nga ligji në protokollin e D.R.T-ve Shkodër. Pra nuk ka asnjë reagim të subjektit, adresuar Drejtorise Rajonale të Tatimeve Shkodër në lidhje me mosfunksionimin e sistemit tatimor ditën kur ai "duhet të bënte këtë deklaram".

Në lidhje me pretendimin e paditësit për deklarimin e punonjësit në Zyrën e Punës Gjykata cmon, se ligji e detyron paditësin që këtë deklaram në formën, mënyrën dhe afatin e përcaktuar ta bëjë para organit tatimor në këtë rast Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër dhe se deklarimi në Zyrën e Punës nuk e përjashton nga përgjegjësia.

Në lidhje me pretendimin se paditësi i ka paguar sigurimet shoqërore të punonjësit të padeklaruar që

nga dita e fillimit të tij të punës Gjykata cmon, se pavarësisht pretendimeve në lidhje me pagesat e bëra për detyrimet përkatëse nga subjekti paditës në momentin e kontrollit punonjësi në fjalë nuk ka qënë i deklaruar konform rregullave para organit tatimor dhe pikërisht kjo është shkelje administrative që e penalizon me gjobë paditësin.

Duke u bazuar në sa me sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma “c” të Ligjit Nr. 49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, përfundimisht cmon, se vendimi i gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet ndryshuar dhe duhet rrëzuar padia.

Lidhur me shkeljen e kryer nga pala paditëse, konkretisht mosdeklarimin e punonjësit kjo Gjykate vlerëson të drejtë dhe të bazuar përfundimin e arritur nga pala e paditur të pasqyruar në aktin, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore të kundërshtuar nga pala paditëse me padinë në gjykim.

Lidhur me të drejtën për të paraqitur rekurs kundër këtij Vendimi, në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ, Gjykata cmon se:

Objekt i padisë në gjykim është kundërshtimi i njoftimit të vlerësimit për detyrimin tatimor nr. .. prot, date 09.10.2015 të nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër dhe vendimit nr..... prot, date 18.12.2015 për lënien ne fuqi të njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. ... prot, datë 09.10.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

Në nenin 56 të Ligjit 49/2012 parashikohet se:

“Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt:

a) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

Në rastin në shqyrtim akti administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor nr. .. prot, datë 09.10.2015 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër është akt që përmban detyrim në të holla në masën 500.000 leke, pra në një shumë më të vogël se 40 fishi i pagës minimale në shkallë vendi, c`ka do të thotë, se ndaj Vendimit të gjykatës Administrative të Apelit nuk mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

### **Vendim:**

Gj.Ad.A me vendimin Nr.1514 datë 16.05.2019 vendosi :

- *Ndryshimin e vendimit nr.410 datë 03.06.2016 të Gj.Ad.Sh.P.Shkodër në këtë mënyrë:*
- *Rrëzimin e padisë*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit*

## **15. Vendim Nr. 605 Datë 10.07.2019**

### **Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Durres**

**Paditës:** “Y.S”

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan

**Objekti:**

- Kerkoj pavlefshmerine e titullit ekzekutiv "proces-verbal Gjobe" me nr serie \_ datë 9.09.2011 si dhe te aktit me nr. \_ prot date 04.03.2019 "njoftim dhe kerkese per tu paguar", të leshuara nga ana e paditur

- Konstatimin e Pavleshmërisë së aktit Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore me nr. \_ prot, date 04.10.2011 te nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.

**Shuma e detyrimit tatimore:** 500000 Lekë.

**Baza Ligjore:**

1. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
3. Ligji nr. 10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative," i ndryshuar.

**Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Subjekti “Y.S” me nipt: \_, në bazë të akt-konstatimit me nr. \_ date 09.09.2011, konstatohet se subjekti është i regjistruar por nuk është i pajisur me kase fiskale, dhe si rrjedhojë, me proces-verbalit e gjobës me nr. \_ datë 09.09.2011, subjektit i është vendosur masa administrative gjobë në vlerën 500000 lekë.

DRT-Elbasan në zbatim të detyrave të saja funksionale nxjerr aktin administrativ Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore me nr. \_ prot, date 04.10.2011.

Subjekti në bazë të ligjit me nr. 10279, date 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i ndryshuar, kërkon pavlefshmërinë e aktit administrativ me arsyetimin se ka kaluar afati 2 vjeçar për ekzekutimin e aktit administrative.

**Arsyetimi ligjor i gjykatës:**

Gjykata në arsyetimi ligjorë, konkludon që vendimi vendimi objekt kundërshtimi ne kete gjykim, eshte nxjerre nga nje organ i identifikuar dhe brenda kompetencave ligjore. Eshte respektuar procedura e nxjerrjes se aktit ne kuptim të ligjeve si me siper të cituara

Paditesi nuk legjitimohet ne kerkimin e tij sipas bazes ligjore të vendosur ne kerkese padi dhe per rrjedhoje gjykata konkludon ne rrezimin e saj. Provohet qe prej paditesit të jene shkelur dispozitat ligjore ashtu sikurse organi administrativ e pretendon.

Padia duhet të rrezohet pavaresisht faktit se pala paditese gëzon legjitimitet aktiv për të ngritur padinë objekt shqyrtimi administrativ. Kjo, në vështrim të neneve 31, 32 të K.Pr.Civile dhe nenit 15 të Ligjit ‘Për Gjykatat Administrative’. Kjo, pavaresisht faktit se paditësi rezulton të kenë një

interes të ligjshëm për të ngritur padi dhe legjitimitet për të vepruar. Legjitimiteti aktiv, ashtu dhe ai pasiv janë parakushte procedurale për të shqyrtuar themelin e çështjes.

**Vendimi i gjykatës:** Rrezimin e kerkese padise

## **16. Vendim Nr. 2530 Datë 26.09.2019**

### **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**

**Paditës:** Shoqëria “K.E”sh.p.k.

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Gjirokastrë.

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Gjirokastrë.

**Objekti:** Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ “Njoftim i Vlerësimit të Kontrollit Tatimor” me nr.\_ Prot. datë 24.10.2014 si dhe të “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet” me nr.\_ Prot. datë 11.06.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Gjirokastrë.

**Shuma e detyrimit tatimore:** Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_ prot. datë 11.06.2014, dhe nr.\_ prot. datë 24.10.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë për detyrimet në shumën totale 11.237.603 lekë.

### **Baza Ligjore:**

1. Kodi i Procedurës Civile, nenet 31, 32, 154, 324–333,
2. Kodi i Procedurave Administrative nenet 116/3 i ligjit
3. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

### **Përmbledhje e rrethanave të faktit:**

Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ka ushtruar kontroll pranë palës paditëse në Muajin Qershor 2014, për inicimin e të cilit ka shërbyer shkresa nr.\_prot., datë 20.05.2014, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qëndror (Sektori i Hetimit), për verifikimin e katër Faturave Tatimore të lëshuara nga paditësi. Në vijim të procedurës me Njoftimin për Vizitë Fiskale nr.\_prot, datë 26.05.2014, paditësi është njoftuar për kontrollin që do të kryhej dhe të drejtat e tij. Me shkresën nr.\_prot.datë 11.06.2014, është dërguar Raport Kontrolli Tematik për subjektin.

Në përfundim të kontrollit paditësi, është njohur me Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. \_ prot.datë 11.06.2014, që pasqyron detyrimet për TVSH dhe Tatim Fitimin, në shumën totale 7.972.829 lekë. Nga paditësi nuk është depozituar asnjë kundërshtim me shkrim lidhur me rezultatet e kontrollit.

Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ka ushtruar kontroll pranë palës paditëse edhe në Muajin Korrik 2014, për inicimin e të cilit ka shërbyer shkresa nr. \_ prot, datë 10.07.2014, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qëndror (Sektori i Hetimit), propozim për kontroll të thelluar. Me shkresën nr. \_ prot., datë 02.07.2014, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Sektori i Analizës së Riskut, është dërguar Formulari nr. 4 për muajin Korrik 2014, për listën e tatimpaguesve me risk të përzgjedhur për tu kontrolluar për muajin Korrik 2014.

Në vijim të procedurës me Njoftim Kontrolli Tatimor nr. \_ prot., datë 02.07.2014, paditësi është njoftuar për kontrollin që do të kryhej dhe të drejtat e tij. Me shkresën nr. \_ prot., datë 24.09.2014, është dërguar Projekt Raport Kontrolli Tatimor për subjektin. Nga paditësi nuk është depozituar asnjë kundërshtim me shkrim lidhur me rezultatet e kontrollit. Me shkresën nr. \_ prot., datë 24.10.2014, është dërguar Raport Kontrolli Tatimor Përfundimtar për subjektin. Nga paditësi nuk është depozituar me shkrim asnjë kundërshtim lidhur me rezultatet e këtij kontrolli.

Në përfundim të kontrollit paditësi, është njohur me Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. \_ prot. datë 24.10.2014, që pasqyron detyrimet dhe penalitetet në përfundim të kontrollit, për të gjitha llojet e tatimit dhe periodat e kontrolluara në shumën totale 3.264.774 lekë.

Paditësi duke mos qenë dakort me rezultatet e kontrolleve të ushtruara nga ana jonë më shumë se një vit pas marrjes dijeni për rezultatet e tyre, i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duke kërkuar pavlefshmëri absolute e aktit administrativ “Njoftim i Vlerësimit të Kontrollit Tatimor” me nr. \_ Prot. datë 24.10. si dhe të “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet” me nr. \_ Prot. datë 11.06.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

### **Arsyetimi ligjor i gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit pasi u njoh me shkaqet e paraqitura në ankim, provat e marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë, aktet procedurale si dhe arsyetimin e vendimit objekt ankimi arrin në përfundimin se vendimi Nr.5, datë 11.01.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë duhet të ndryshohet duke proceduar me rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Administrativ vlerëson se analiza e argumenteve të gjykatës së shkallës së parë, rrjedhimisht edhe e shkaqeve të ngritura në ankimin e palës së paditur, konsiston në verifikimin e zbatimit ose jo të kufijve të shqyrtimit gjyqësor, përcaktuar në Nenin 37/1 të Ligjit Nr.49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”, sipas përmbajtjes së të cilit...

Lidhur me situatën ligjore, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se në nenin 115 K.Pr.Administrative (në fuqi në kohën e ngritjes së padisë, tashmë i shfuqizuar), parashikohej se...

Referuar shkakut dhe objektit të kërkesëpadisë, rezulton që paditësi "K.E" sh.p.k ta ketë orientuar shqyrtimin gjyqësor, në funksion të verifikimit të elementeve të pavlefshmërisë absolute të

akteve objekt gjykimi, në kuptim të Nenit 116/b,c të K.Pr.Administrative, sipas përmbajtjes së të cilit përcaktohet se...

Gjykata Administrative e Apelit evidenton se aktet objekt kundërshtimi në këtë gjykim janë Njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_ prot.datë 11.06.2014 dhe nr.\_ prot. datë 24.10.2014 të DRT Gjirokastrë, akte të cilat janë nxjerrë në bazë të të dhënave të raporteve respektive të kontrollit të datës 02.06.2014 dhe 20.10.2014 në zbatim të Ligjit Nr.9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në lidhje me pretendimet për kompetencën e organit që ka nxjerrë aktin, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se ky akt është nxjerre nga organi kompetent i përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr.9920/2008 sipas të cilit përcaktohet se...

Në nenin 68.5 të Ligjit nr.9920/2008 përcaktohet se...

Në kreun X të ligjit me titull "Kontrolli tatimor" në nenet 80–87 përcaktohen procedurat e kryerjes së kontrollit tatimor e më konkretisht në nenin 85 të tij përcaktohet rikontrolli tatimor si vijon...

Ndryshe nga sa arsyetohet në vendimin objekt ankimi, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një rikontroll tatimor të mirëfilltë pasi kontrolli i parë i iniciuar me shkresën nr.\_ prot. , datë 26.05.20014 "Njoftim për vizite fiskale". Kontrolli ka pasur si qëllim verifikimin vetëm të katër faturave me TVSH me nr.\_, datë 19.07.2013, nr.\_, datë 09.10.2013, nr.\_, datë 09.11.2013 dhe nr. 87674272, datë 01.11.2013, ndërsa me shkresën nr.\_ prot, datë 02.07.2014 pala e paditur ka njoftuar palën paditëse "K.E" sh.p.k ushtrimin e një kontrolli tatimor, i cili ka pasur si qëllim verifikimin e problemeve të tatimpaguesit me administratën tatimore, kontrollin për TVSH–në në periudhën janar 2011–qershor 2014, tatim fitimin dhe të ardhurat personale për periudhën 2010–2013, sigurimet shoqërore deri në qershor 2014.

Nga përmbajtja e Njoftim vlerësimit të detyrimeve tatimore nr.\_ prot., datë 24.10.2014 nuk rezulton të ketë mbivendosje me detyrimet tatimore të njoftuara me aktin Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.\_ prot., datë 11.06.2014.

Gjykata Administrative e Apelit evidenton se në pikën 108.3.4 të Udhëzimit Nr.24/2008, parashikohej se...

Në lidhje me situatën faktike dhe provat e paraqitura, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se kontrolli i iniciuar me shkresën nr.\_, datë 26.05.2014, rezulton se është kryer mbi vendimin e drejtorit të DRT Gjirokastrë, por edhe kontrolli i iniciuar me shkresën nr.4070, datë 02.07.2014, është kryer mbi vendimin e drejtorit të DRT Gjirokastrë duke u mbivendosur pjesërisht periudha e kontrollit të urdhëruar me shkresën nr.\_, datë 26.05.2014, por pa u marrë në konsideratë detyrimet tatimore të gjeneruara nga ky kontroll.

Në analizë të fakteve të parashtruara më sipër, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se si Njoftim vlerësimi tatimor nr.\_ prot., datë 11.06.2014, dhe ai nr.\_ prot., datë 24.10.2014, janë nxjerrë nga Drejtori i DRT Gjirokastrë dhe janë nënshkruar prej tij, si organi administrativ kompetent i përcaktuar në nenin 70.1 të ligjit nr.9920/2008 dhe pikën 70.1 të Udhëzimit nr .24/2008 për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore. Pra akti objekt kundërshtimi nuk rezulton të jetë nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.

Pretendimet e palës paditëse se njoftim vlerësimi objekt kundërshtimi nr.4071/5 prot., datë 24.10.2014 është nxjerrë nga DRT Gjirokastrë papajisur me autorizim nga Drejtori i

përgjithshëm i tatimeve sipas nenit 85 të Ligjit nr.9980/2008 është një pretendim, i cili ka të bëjë me procedurën e ushtrimit të kontrollit nga organet e administratës tatimore.

Referuar përmbajtjes së nenit 40.4 të Ligjit nr.49/2012, Gjykata arrin në konkluzionin se jo çdo shkelje e procedurës në nxjerrjen e një akti administrativ përbën shkak për pavlefshmërinë, e tij. Një shkelje e procedurës do të përbënte shkak për pavlefshmerinë e aktit administrativ në rast se respektimi rigoroz i saj do të sillte pasoja të ndryshme në vendimmarrjen e organit administrativ, që do të thotë se nëse procedura do të ishte respektuar, nuk do të kishim një rikontroll tatimor ndaj paditësit dhe për pasojë as një rivlerësim tatimor të detyrimeve tatimore.

Në funksion të zbatimit të kësaj dispozite, shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit administrativ, do të duhej të ishte orientuar në funksion të verifikimit të ekzistencës ose jo të së njëjtës situatë faktike, si në rast respektimi, ashtu edhe në rast mosrespektimi të procedurës së nxjerrjes së aktit (njoftim-vlerësimi objekt gjykimi), duke qenë se pikërisht kjo rrethanë bën në këtë rast diferencën, në analizën e pretendimeve për mosrespektim të procedurës.

Gjykata eidenton se rezultatet e kontrollit tatimor të konkluduara me Njoftim vlerësimin nr.\_ prot., datë 11.06.2014, janë detyruese për DRT Gjirokastrë sipas nenit 85.1 të ligjit nr.9920/2008 dhe DRT Gjirokastrë e njoftim vlerësimin e dytë nr.\_ prot., datë 24.10.2014, nuk ka rilogaritur detyrime për çështjet e trajtuara me Njoftim vlerësimin nr.\_ prot., datë 11.06.2014.

Sa me sipër, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se mungesa e miratimit të rikontrollit tatimor nga Drejtori i Përgjithshëm i tatimeve, nuk përbën shkak për të deklaruar njoftim vlerësimin si absolutisht të pavlefshëm.

Autorizimi për rikontroll tatimor është një garanci për tatimpaguesin ndaj kontrolleve të pajustificuara dhe të përsëritura të administratës tatimore, por nuk mund të përdoret si një mbrojtje për tatimpaguesin, të cilët i shmangen pagimit të detyrimeve tatimore.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se mungesa e autorizimit për kryerjen e rikontrollit do të mund të përbënte shkak për pavlefshmëri të njoftim vlerësimit, për efekt të mosrespektimit të procedurës në rast se rikontrolli do të ishte ushtruar në mungesë të rrethanave të përcaktuara në nenin 85 të Ligjit nr.9920/2008, pra nëse me Njoftim vlerësimin nr. \_ prot., datë 24.10.2014, do të rilogariteshin detyrime për çështjet e trajtuara me Njoftim vlerësimin nr.\_ prot., datë 11.06.2014.

Në lidhje me pretendimet se njoftim vlerësimi nuk është nxjerrë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9920/2008, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se përbëjnë pretendime që kanë të bëjnë me pavlefshmerinë relative të aktit dhe si të tilla nuk merren në shqyrtim nga kjo gjykatë, për aq kohë sa paditësi nuk ka plotësuar kushtin formal të pranueshmërisë së padisë për shqyrtim, atë të parapagimit të detyrimit tatimor sipas nenit 107 të Ligjit nr.9920/2008 dhe shterimit të ankimit administrativ para organit me të lartë administrativ Drejtoria e Apelimit Tatimor.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma “c” të Ligjit Nr.49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar vlerëson se vendimi Nr.05, datë 11.01.2016, i Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Gjirokastrë duhet të ndryshohet duke proceduar me rrëzimin e padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ duke qenë se nuk u verifikuan elemente të kësaj pavlefshmërie, ndërsa pretendimet e themelit në lidhje me pavlefshmërinë relative nuk u shqyrtuan për shkak se pala paditëse nuk ka ezaruaruar ankimin



administrativ dhe për pasojë mund të ngrejë padi në lidhje me to, pa plotësuar një ndër parakushtet procedurale të pagesës së detyrimit tatimor, i cili është vendosur me ligj si kusht për marrjen në shqyrtim si të ankimit administrativ dhe atij gjyqësor.

**Vendimi i gjykatës:** Ndryshimin e vendimit Nr.05, datë 11.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Gjirokastrë në këtë mënyrë:  
Rrëzimin e padisë.

## **17. Vendim Nr. 3151 Datë 12.12.2019**

### **Gjykata Administrative Apelit**

**Paditës:** Shoqëria “Y” sh.p.k,

**I paditur:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelit Tatimor  
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

### **Objekti:**

1. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit nr.\_ prot datë 14.06.2013 dhe nr.\_ prot datë 31.07.2013 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.
2. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.\_ prot datë 21.10.2013 dhe vendimit nr.\_ prot datë 04.10.2013 të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelit Tatimor”

**Shuma e detyrimit:** 6 694 477 lekë

### **Baza Ligjore:**

1. Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68, neni 71, 72 pika (a), (b), neni 114, 115, 116 .... ,
2. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar,
3. Ligji nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar,
4. Udhëzimi nr.6 datë 02.09.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar ...

### **Përmbledhje e Fakteve:**

Shoqëria “Y” sh.p.k është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me numër Nipti J 78716319 A, me objekt aktiviteti “ndërtim...”

Subjekti paditës i është drejtuar gjykatës fillimisht me kërkesë-padi me objekt gjykimi komunikuar nga gjykata: “kundërshtim njoftim vlerësimi nr. \_ prot datë 14.06.2013 për 4.496.280 lekë dhe nr.\_ prot datë 31.07.2013 për 2.198.197 lekë të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër”

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar shoqërinë me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.\_ prot datë 14.06.2013 për 4.496.280 lekë dhe nr.\_ prot datë 31.07.2013 për 2.198.197 lekë, në të cilët janë pasqyruar në mënyrë të detajuar këto detyrime sipas zërit përkatës tatimor dhe periudhave përkatëse tatimore.

"Y" sh.p.k me numër Nipti \_ ka blerë me fatura tatimore te subjekti "X" sh.p.k ku rezulton, se kjo shoqëri nuk ka ushtruar aktivitetin për të cilin është krijuar, por është marrë vetëm me lëshimin e faturave fiktive, të pashoqëruara me mall dhe kjo ka sjellë kreditim të padrejtë të tatimit mbi vlerën e shtuar nga subjektet blerëse të këtyre faturave.

Mbi bazën e kësaj praktike dhe informacion të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër është mbajtur Akt konstatimi nr.\_prot datë 07.06.2013 sipas të cilit janë bërë rivlerësimet përkatëse në lidhje me subjektin "Y" sh.p.k, pasi janë kontrolluar nëpërmjet TAX CRM-së (sistemi informatik i deklarimit të librave të blerjes dhe shitjes) librat e blerjeve 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11, situata fiskale e subjektit në SIT (sistemi informatik tatimor), bazuar në Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, Ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Udhëzimin nr.17 datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

Nga kontrolli i blerjeve të këtij subjekti brenda vendit për këto periudha (janë paraqitur para Gjykatës me vlerën e provës Librat e blerjeve, deklaruar nga subjekti "Y" sh.p.k para organit tatimor, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, detyrim ligjor ky për të, për periudhat tatimore 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11) është konstatuar, se shoqëria ka rregjistruar të gjitha faturat e blera nga shoqëria "X" sh.p.k në shumën 17.985.120 lekë, me t.v.sh në vlerën 3.597.094 lekë.

Sipas shkresës nr.\_prot datë 17.05.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë është kryer saktësimi i faturave të shitjes nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës për shoqërinë "X" sh.p.k dhe është konstatuar, se këto fatura janë fiktive dhe se ky subjekt nuk ka ushtruar aktivitetin për të cilin është krijuar.

Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, Drejtoria e vlerësimit janë kryer rivlerësimet përkatëse në zbatim të Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 68, neni 71, 72 pika (a), (b), duke kryer rivlerësim tatimor për tatimin mbi vlerën e shtuar, në mosnjohje kreditimi për këto fatura.

(Janë paraqitur para Gjykatës të printuara nga sistemi informatik tatimor versionet, situatat fiskale të subjektit të rivlerësuar për periudhat tatimore 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11 versioni (3)).

Pra në interpretim të dispozitave të mësipërme një ndër elementët kryesore për të përfituar të drejtën e kreditimit është dokumentacioni, ku mbështetet ky kreditim, konkretisht fatura tatimore.

Mungesa e saj ose mangësitë në plotësimin e elementëve të saj passjellin humbjen e së drejtës për të përfituar kreditimin e tatimit. Sipas këtyre akteve ligjore e nënligjore, e drejta për të përfituar kreditimin e TVSH-së së paguar në blerje lidhet me një sërë kushtesh kryesore, që duhet të plotësohen nga tatimpaguesi si :

-Tatueshmëria e furnizimit të cilit i ka shërbyer furnizimi i marrë, për të cilin kërkohet kreditimi i TVSH-së së paguar.

-Qëllimi i furnizimit të marrë dhe lidhja e ngushtë me veprimtarinë e tij ekonomike.

- Klasifikimi i furnizimit të marrë si furnizim i tatueshëm dhe mospërfshirja e tij në llojet e furnizimeve të përjashtuara të përcaktuara në Ligjin nr.7928 dt.27.04.1995 “Për TVSH-në” apo në furnizimet për të cilat nuk lejohet kreditimi i TVSH-së sipas Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008 për zbatimin e këtij ligji paragrafi 19.4.

-Dokumentimi i furnizimit të kryer nëpërmjet dokumentacionit bazë të T.V.SH-së, faturës tatimore të plotësuar në përputhje me kërkesat e nenit 36 të këtij ligji.

Referuar përkufizimeve të sipërcituara, furnizimi i kryer për shoqërinë “Y” shp.k nga furnitori i saj gëzon të drejtën e kreditimit, nëse është në përputhje me nenin 33, pika 1 e Ligjit nr.7928 dt.27.04.1995 “Për TVSH-në” dhe nëse nuk është pjesë e përjashtimeve të përcaktuara në pikat (2 - 3) të këtij neni. Ky nen së bashku me nenin 32 pasqyrojnë në mënyrën më të saktë parimin e mbartjes së TVSH-së nga njëri furnizues te tjetri, dispozita të cilat rregullojnë pagesën dhe kreditimin e TVSH-së.

Pra nëse një furnizim miratohet si i saktë, krahasuar me përcaktimet ligjore në lidhje me to, nga administrata tatimore tatimpaguesit blerës të këtij furnizimi i lind e drejta e kreditimit të tatimit të paguar në këtë furnizim, duke shmangur në këtë mënyrë pagesën dyfishe të TVSH-së.

Në rastin objekt gjykimi vlerësimi tatimor është kryer në lidhje me këto furnizime të kryera...

Pra për shoqërinë që ka kryer furnizimin është konstatuar se ka kryer shitje fiktive dhe nuk ka ushtruar aktivitet për të cilin është liçensuar, gjithashtu nuk është vërtetuar nëse këto shitje janë deklaruar nga shoqëria që ka kryer këto furnizime.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për Apelim, Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Drejtorja e Apelimit Tatimor është përgjigjur me vendimin e saj nr.\_prot datë 21.10.2013, nëpërmjet të cilit vendos: Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.\_ prot datë 14.06.2013 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër për mosnjohje të kreditimit të TVSH-së në shumën 3.597.024 lekë dhe të gjobave në vlerën 899.256 lekë.

Në lidhje me vlerësimin tatimor sipas njoftim vlerësimit nr.\_ prot datë 31.07.2013 objekt gjykimi për 2.198.197 lekë kemi sqaruar para Gjykatës si më poshtë: Subjekti në vazhdimsi të periudhave tatimore ka vijuar duke bërë deklarin e detyrimeve të tij për TVSH-në duke marrë të mirëqenë tepricën e tij kreditore. Sikurse shprehëm më lart gjendja kreditore e t.v.sh-së për subjektin mbartet nga njëra periudhë në tjetrën.

Duke iu referuar situatës financiare të subjektit nuk ka rezultuar gjendje e mjaftueshme e tepricës kreditore për të mbuluar detyrimet e periudhës mars 2013. Përveç detyrimit nga sistemi informatik në bazë të ligjit tatimor për “Tatimin mbi vlerën e shtuar”, Ligjit “Për procedurat tatimore” të

përmendur më lart dhe Udhëzimeve përkatëse, llogariten gjobat dhe kamatëvonesat për pagesë të vonuar.

Subjekti ka rezultuar me detyrim pa paguar për periudhën tatimore mars 2013, pas rivlerësimeve të periudhave tatimore 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11 vetë sistemi informatik tatimor tashmë gjeneron vlerësimin tatimor, sanksionet për mospagesë në afat, neni 114 dhe kamatëvonesë në zbatim të ligjit “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar .

Neni 114 shpreh:

“Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, i cili pasqyrohet në njoftim vlerësimin tatimor. Subjekti është njoftuar me detyrimin sipas njoftim vlerësimit nr.\_ prot datë 31.07.2013.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore në lidhje me këtë njoftim vlerësim.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj nr.\_prot datë 04.10.2013, komunikuar me shkresën nr.\_prot datë 04.10.2013 subjektit dhe për dijeni Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron atë të papranueshëm, pasi nuk është bërë pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi (pa gjobat), të përcaktuar në aktin administrativ, që ankimohet njoftim vlerësimin tatimor, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.

Fillimisht gjatë gjyqimit të kësaj çështje nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë

Shkodër u kërkua informacion zyrtar nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, e cila u përgjigj me shkresën nr.\_prot datë 16.12.2013 nëpërmjet të cilës informon, se mbi bazën e materialit kallzues të referuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Hetimit Tatimor datë 21.01.2013 ka rregjistruar procedimin penal nr.29/2013 për veprën penale referuar në këtë shkresë, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, në ngarkim të përfaqësuesit ligjor të subjektit “X” sh.p.k.

Ndër subjektet të cilët kanë daklaruar në blerje para organit tatimor fatura tatimore të subjektit në fjalë përcaktohet dhe subjekti paditës Shoqëria “Y” sh.p.k, me numër Nipti \_.

Pra kallzimi penal lidhej me subjektin “X” sh.p.k, “faturat e parregullta apo fiktive” konstatuar administrativisht nga administratat tatimore.

Faturat përkatëse (referuar librave të blerjes, deklaruar nga subjekti para organit tatimor dhe komunikuar para gjykatës me vlerën e provës) konstatohet, se janë deklaruar në blerje nga subjekti paditës “Y” sh.p.k.

Sipas shkresës nr.\_prot datë 17.05.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë është kryer saktësimi i faturave të shitjes nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës për shoqërinë “X” sh.p.k dhe është konstatuar, se këto fatura janë fiktive dhe se ky subjekt nuk ka ushtruar aktivitetin për të cilin është krijuar.

Pra për shoqërinë që ka kryer furnizimin është konstatuar se ka kryer shitje fiktive dhe nuk ka ushtruar aktivitet për të cilin është licencuar, gjithashtu nuk është vërtetuar nëse këto shitje janë deklaruar nga shoqëria që ka kryer këto furnizime.

Mbi këto fakte e konstatime është bërë në vijim vlerësimi përkatës tatimor objekt i këtij gjykimi.

Me shkresën nr. \_prot datë 16.12.2013 Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës i dërgon Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kopje të faturave tatimore të shitjes, me shitës subjektin “X” sh.p.k, me blerës subjektin “Y” sh.p.k, fatura të cilat bën të ditur Prokuroria i janë sekuestruar subjektit “Y” sh.p.k, të cilat i ka deklaruar si blerje pranë organeve tatimore ky subjekt.

Pala paditëse në këtë gjykim në seancën e datës 19.04.2017 paraqiti para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me vlerën e provës Vendimin Penal të Gjykatës së Apelit Shkodër nr.466 datë 10.12.2015.

Referuar këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër nr.466 datë 10.12.2015, faqe 114 ai shpreh:

Janë sekuestruar faturat tatimore që subjekti “Y” sh.p.k ....kishte deklaruar si blerje nga subjekti “X” faturat tatimore me numër serie .....

....., (citohen një nga një) në vijim në faqen 115 të këtij vendimi shprehet :

“Nga njëra anë subjekti “X” nuk ka deklaruar para organit tatimor asnjë faturë blerje që të justifikojë blerjen e paisjeve që i janë shitur subjektit “Y” sh.p.k dhe nga ana tjetër këtyre paisjeve nuk u është specifikuar origjina e tyre transporti i bërë është realizuar me mjete që nuk janë në pronësi të subjektit “X” sh.p.k, nuk është paraqitur asnjë kontratë apo dokument për të justifikuar marrjen e këtyre mjeteve nga pronarët ..... Në këto rrethana formularët e paraqitur janë të fallsifikuar në përmbajtje dhe ..... Nga këto fakte rezulton, se subjekti “X” sh.p.k në asnjë rast nuk ka kryer punime dhe shitur pajisje të ndryshme subjektit “Y” sh.p.k, me përfaqësues ligjor shtetasin Preng Deda, por këto fatura të deklaruar nga subjekti “Y” sh.p.k, të deklaruar pranë organit tatimor janë fiktive. Pra këto fatura janë bërë me qëllimin e vetëm që këto subjekte në bashkëpunim me njëri tjetrin të përfitonin nga tatim-taksat në mënyrë të padrejtë”.

Referuar këtij vendimi faqe, 117, 118, 119, 120 flitet për përgjegjësi penale të subjektit Shoqëria “Y” sh.p.k.

Pretendimi i palës paditëse në gjykim, se “nuk është deklaruar fallsiteti dhe asgjësimi i faturave që lidhen me vlerësimin e organit tatimor ndaj subjektit “Y” sh.p.k” nuk qëndronte, pasi referuar po këtij vendimi të Gjykatës pala paditëse në këtë gjykim Shoqëria “Y” sh.p.k deklarohet fajtores dhe nga gjykata merret dënimi përkatës ndaj shoqërisë, referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nr.466 datë 10.12.2015, faqe 237, pika 9 (nëntë) dhe faturat objekt vlerësimi nga organi tatimor janë konstatuar të parregullta.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj penal nr.466 datë 10.12.2015 në pjesën e fundit të dispozitivit të saj vendos:

“Prishjen e vendimit nr.230 datë 01.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për asgjësimin e disa faturave .... duke u cituar ato një nga një”, por ato numra serialë, data të faturave të cituara nuk identifikojnë faturat objekt vlerësimi nga organi tatimor ndaj Shoqërisë “Y” sh.p.k, faturat objekt vlerësimi janë deklaruar nga subjekti paditës para organit tatimor, janë dorëzuar para gjykatës me vlerën e provës librat e blerjeve të subjektit të deklaruar para organit tatimor për periudhat 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11 (shprehen të dhëna mbi faturat e deklaruar një nga një), situata fiskale e subjektit në SIT (sistemi informatik tatimor).

Pra faturat objekt vlerësimi nga organi tatimor me vendim të Gjykatës u konstatuan të parregullta, ç’ka konfirmoi vlerësimin e organit tatimor në adresimin e procedimit penal dhe në vijim vlerësimin tatimor të kryer administrativisht.

### **Arsyetimi ligjor i Gjykatës:**

***Fillimisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.75/04 Rregjistri datë 21.01.2014 ka vendosur:***

Pezullimin e gjykimit të çështjes. Kundër këtij vendimi ka berë ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.20 date 09.05.2014 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr.75/04 Rregjistri, themeliar, date 21.01.2014 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkoder dhe kthimin e çështjes ne po ate gjykate per vazhdimin e gjykimit.

***Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr.320 datë 16.05.2017 ka vendosur :***

- Rrezimin e kerkese padisë

***Mbi bazën e ankimit të palës paditëse çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Gj.Ad.A me vendimin nr.3151 datë 12.12.2019 vendosi :***

Lënien në fuqi të vendimit nr.320 datë 16.05.2017 të Gj.Ad.Sh.P.Shkodër

Kundër vendimit lejohet rekurs

***Gjykata Administrative e Apelit çmon***, se vendimi nr.320 datë 16.05.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit për pasojë ai duhet të lihet në fuqi nga kjo gjykatë.

Kolegji vlerëson, se gjykata administrative e shkallës së parë ka bërë vlerësim të drejtë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me çështjen objekt gjykimi.

Kjo gjykatë konstaton, se gjithë pretendimeve të paraqitura në ankim u është dhënë zgjidhje me vendim nga gjykata e shkallës së parë. Ky vendim rezulton te jete rrjedhoje e nje analize te hollesishme te rrethanave te faktit e te ligjit, qe janë përcaktuar në mënyrë të plotë e të drejtë. Kjo analize rezulton te jete plotesisht e bazuar ne kriteret e dispozitave perkatese te permendura ne vendim, lidhur me vlerësimin nga ana e gjykates se shkallës se pare te akteve administrative objekt gjykimi, si akte të nxjerra në mbështetje të plotë me ligjin.

Kolegji Administrativ i Apelit ne analize te vendimit te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkoder, te ankimit, te provave dhe fakteve objekt gjykimi çmon të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata administrative e shkalles se pare dhe vlereson, se jane te pabazuara ne ligj dhe ne prova pretendimet e paditesit se “aktet objekt gjykimi jane nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji me argumentin, qe nuk eshte bere kontrolli ne vend, i subjektit "Y" sh.p.k, por eshte bere kontroll nga zyra ne kundershtrim me ligjin”, pasi metoda alternative e perdorur per kontroll sipas nenit 68 dhe 72 te ligjit nr.9920/2008 nga pala e paditur jo vetem qe eshte mënyrë kontrolli e parashikuar në ligj, por e domosdoshme per t’u perdorur, pasi vete subjekti Y” sh.p.k i eshte drejtuar kesaj drejtorie me kërkesë për rimbursim me nr.309 datë 02.09.2013, per te cilen kjo Drejtori i është përgjigjur subjektit me shkresën nr.309/1 prot datë 16.09.2013.

Nga rrethanat e faktit, legjislacioni i zbatueshem dhe kërkit të palëve lind me të drejtë analiza e kërkesave të nenit 116 të K.Pr.Adm mbi të cilen paditesi kërkon të bëjë mbrojtjen e pretendimeve të veta para gjykatës me qellim për të konkluduar në “pavlefshmerinë absolute” të pretenduar sipas nenit 116 pika 3 e tij.

Neni 116 i K.Pr.Ad shprehet ne lidhje me "Aktet administrative absolutisht te pavlefshme" :

"Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme ne kuptimin e ketij Kodi ne rastet e meposhtme :

- a) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ i paidentifikuar
- b) kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore
- c) kur akti eshte nxjerre ne kundershtrim me formen dhe proceduren e kerkuar nga ligji

Ne analize te ankimit e te provave te paraqitura ne dosjen objekt gjykimi rezulton e provuar, se aktet administrative objekt gjykimi jane nxjerre nga nje organ administrativ kompetent siç eshte DRT-Shkoder, e cila ne zbatim te ligjit nr.9920/2008, i ndryshuar ka kompetencen ligjore per vlerësimin dhe nxjerrjen e detyrimeve tatimore ndaj çdo tatimpaguesi nen juridiksionin e saj siç eshte ne rastin konkret dhe paditesi Shoqeria "Y" sh.p.k, i cili eshte subjekt tregtar ne administrim te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder, me numer Nipti \_ per pasoje eshte provuar se keto akte administrative, njoftim vleresimet tatimore nuk jane nxjerre as ne kapercim te kompetencave te ligjore te administrates tatimore Dega Rajonale Shkoder.

Në Nenin 68 të Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Vlerësimi tatimor" përcaktohet se :

#### 1. Vlerësimi tatimor

- a) është llogaritja e detyrimit tatimor te tatimpaguesit nga administrata tatimore

5. Administrata tatimore vlereson detyrimin tatimor te tatimpaguesit ne perputhje me dispozitat e legjislacionit perkates.

Vleresimi bazohet në: d) informacionin, qe permban deklarata tatimore e tatimpaguesit

- e) rezultatet e nje kontrolli, ne perputhje me kreun X te ketij ligji

f)menyrat alternative te vleresimit, te parashikuara ne nenin 72 te ketij ligji.

Neni 72 i ketij ligji shpreh bazat e menyrove alternative te vleresimit

1.Menytrat alternative te vleresimit nuk kufizohen, por bazohen ne :

c) te dhena te drejtperdrejta, qe gjenden ne deklaratat tatimore ose ne dokumentet apo ne nje informacion tjeter, dhene nga tatimpaguesi

d) te dhena te drejtperdrejta, dokumente ose informacion dhene nga pale te treta ... dhe rrethanave te faktit provohet, se kontrolli ndaj shoqerise "Y" sh.p.k ka ardhur si rezultat i shkreses se Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, e cila i eshte drejtuar me shkresen nr.\_prot date 17.05.2013 me objekt "dergim informacioni" Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder nga ku rezulton, se subjekti "X" sh.p.k, nuk ka ushtruar aktivitetin per te cilin eshte krijuar, por eshte marre vetem me leshimin e faturave fiktive, te pashoqëruara me mall dhe kjo ka sjelle kreditim të padrejtë të tatimit mbi vlerën e shtuar nga subjektet blerëse të këtyre faturave. Nisur nga kjo është kërkuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder te merren masat përkatëse, qe subjekteve të përmendura në këtë shkresë, te cilat kane blere me fatura tatimore te subjekti i mesiperm, te mos i njihet kreditimi i ketyre faturave. Nder te cilet kane blere fatura tatimore percaktohet dhe subjekti padites "Y" sh.p.k me numer Nipti \_ . Rezulton se nga ana e Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder eshte mbajtur Akt konstatimi nr.\_prot date 07.06.2013 sipas te cilit jane bere rivleresimet perkatese ne lidhje me subjektin "Y" sh.p.k, pasi jane kontrolluar nepermjet TAX CRM-se (sistemi informatik i deklarimit te librave te blerjes dhe shitjes) librat e blerjeve 2012/06, 2012/07, 2012/10, 2012/11, situata fiskale e subjektit ne SIT (sistemi informatik tatimor), bazuar ne Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Udhezimin nr.24 date 02.09.2008 per zbatimin e ketij ligji, Ligjin nr.7928 date 27.04.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar, Udhezimin nr.17 date 13.05.2008 "Per tatimin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar. Rezulton se nga kontrolli i blerjeve te ketij subjekti brenda vendit per keto periudha eshte konstatuar, se shoqeria ka regjistruar te gjitha faturat e blera nga shoqeria "X" sh.p.k ne shumen 17.985.120 leke, me t.v.sh ne vleren 3.597.094 leke. Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, Drejtoria e vleresimit jane kryer rivleresimet perkatese ne zbatim te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, neni 68 , neni 71, 72 pika (a), (b), duke kryer rivleresim tatimor per tatimin mbi vleren e shtuar, ne mosnjohje kreditimi per keto fatura. Mbi bazen e ketij rivleresimi kane dale dhe njoftim vleresimi nr.\_ date 14.06.2013, qe ka llogaritur detyrime per T.v.sh-në per 4.496.280 leke dhe njoftim vleresimi nr.\_ date 31.07.2013 objekt gjykimi. Në analizë të sa më siper Kolegji i Gjykatës Administrative vlereson, se kontrolli nga zyra duke kontrolluar nepermjet TAX CRM-së, referuar në vete daklarimet e subjektit, mbi bazen e faturave te deklaruar per shitje hyn ne menyren alternative te kontrollit, e cila është tërësisht e ligjshme, pra nuk gjejnë vend pretendimet “të konsiderohet vleresimi në shkelje të ligjit” siç dhe pala paditëse parashtron gjatë gjykimit.

- **Gjykata Administrative e Apelit** ne analize te dosjes objekt gjykimi te provave dhe fakteve te cilat ndodhen ne te vlereson, se jane te pabazuar ne ligj dhe ne prova pretendimet e paditesit, se Drejtoria e Apelimit Tatimore nuk ka marre ne shqyrtim kerkesen ankimore, por me vendimin nr.\_date



04.10.2013 ka vendosur refuzimin e ankimit per njoftim vlerësimin nr.\_ date 31.07.2013 te DRT Shkoder me arsyetimin, se nuk eshte vertetuar pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi eshte ne shkelje te ligjit per faktin, se shoqëria "Y" sh.p.k ka patur teprice kreditore TVSH-je dhe ka kerkuar kompensim detyrimi per parapagimin e detyrimit tatimor, objekt ankimi, ne perputhje me nenin 75 dhe 107 te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008, pasi mjeti ligjor i perdorur nga paditesi për pavlefshmeri absolute të aktit administrativ njoftim vleresimit nr.\_ date 31.07.2013 te DRT Shkoder eshte teresisht i qellimshem per te detyruar gjykatën që t'i hyjë shqyrtimit gjyqësor te ceshtjes, pasi paditesi në fakt ka shkelur kerkesat e nenit 106 e 107 te ligjit nr.9920/2008. Ne analize te dosjes objekt shqyrtimi gjyqësor rezulton, se shoqeria nuk ka patur kerkese per kompesim te teprices kreditore, por ka patur kerkese per rimbursim TVSH me nr.309 date 02.09.2013, per te cilen kjo Drejtori i eshte pergjigjur me shkresen nr.\_prot date 16.09.2013, refuzim. Pra nga sa me siper rezulton, se tatimpaguesit nuk i jane shkelur te drejtat e percaktuara me ligjin e mesiperm per ankim, tatimpaguesi e ka ushtruar te-drejten themelore per ankimim.

*Rezulton se paditesi ka shkelur kerkesat e nenit 106 e 107 te ligjit nr.9920/2008, ku thuhet:*

Neni 106 i ketij ligji "Objekti i ankimit administrativ tatimor"

- Tatimpaguesi mund të ankimoje kunder çdo njoftim vleresimi, çdo vendimi qe ndikon ne detyrimin e tij tatimor, çdo kerkese per rimbursim ose lehtesim tatimor ose çdo akti ekzekutiv te posaçem tatimor ne lidhje me tatimpaguesin. Ankimi behet me shkrim dhe ne formen e parashikuar ne zbatim të ketij ligji, më udhezim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesi e dorezon ankimin ne Drejtorine e Apelimit Tatimor brenda 30 diteve kalendarike nga data kur vleresimi ose vendimi i administrates tatimore eshte marre ose vleresohet te jete marre nga tatimpaguesi.

Ne nenin 107 te ketij ligji dhe Udhezimin nr.24 date 02.09.2008 per zbatimin e tij pika 107.1 pika (a), (b), 107.2.1 dhe 107.2.2 eshte percaktuar se: kur nje detyrim tatimor eshte objekt ankimi, ankimi pranohet vetem neqoftese ankimuesi në perputhje me nenin 107 (1) te ligjit: paguan shumen e plote te detyrimit tatimor objekt ankimi dhe verteton pagesen duke paraqitur nje kopje te dokumentit te pageses se tatimit. Shuma e detyrimit per tu paguar perfshin vetem shumën e detyrimit dhe kamatevonesen.

Ky mjet ligjor eshte perdoruar nga paditesi ne menyre teresisht abuzive. Ne analize te sa me siper ky kolegji vlereson, se aktet administrative objekt gjykimi nuk jane absolutisht te pavlefshme pasi jane marre nga organi administrativ i identifikuar, jane nxjerre nga organi administrativ ne ushtrimin e kompetencave te tij ligjore dhe jane nxjerre ne perputhje me formen dhe proceduren e kerkuar nsa ligji. Gjykata vë në vëmendje, se pavlefshmeria absolute eshte nje rast ekstrem i pavlefshmerise qe ndodh kur akti eshte ne permbajtje e forme apo i nxjerre ne procedure ne kundërshtim flagrant me ligjin material dhe/ose procedural. Pavlefshmeria absolute sipas Kodit te Procedures Administrative dhe doktrines se te dreites administrative eshte atehere dhe vetem atehere kur shkelja eshte kaq evidente, kaq e qarte sa ajo s'ka as nevojë per ndonje shqyrtim te thelluar por mbi kete pavlefshmeri konkludohet me shikim te pare dhe gjykata vecse sa konstaton nje pavlefshmeri te tille. Jo cdo shkelje procedurale passjell pavlefshmerine absolute te akteve, ato duhet te jene te asaj natyre ne mungese te te cilave vendimmarrja e organit administrative do te

kishte qene e ndryshme, qe ne ceshtjen ne shqyrtim nuk rezulton e tille. Per sa siper Gjykata Administrative e Apelit vlereson, se ankimi dhe padia e paraqitur nga pala paditese eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet rrezuar, qendrim i mbajtur me te drejte dhe nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder lidhur me padine.

- Kolegji Administrativ i Apelit ne analize te dosjes objekt gjykimi te provave dhe fakteve te cilat ndodhen ne te vlereson se pretendimet e pales paditese ne ankim, te cilat jane nje përsëritje të kërkimeve te parashtruar ne shkalle te pare dhe nuk ka asnje prove bindese qe te krijoje bindjen e te determinoje ne ndryshimin e vendimit nuk qendrojne. Ne ceshtjen objekt gjykimi rezulton qarte, qe nga teresia e provave shkresore si dhe nga analiza qe i behet i Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Vleresimi tatimor", Ligjit nr.7928 date 27.04.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar, Udhezimit nr. 17 date 13.05.2008 "Per tatimin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar, Kodit te Procedurave Administrative dhe Ligjit nr 49/2012 "Per Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" te gjitha veprimet e palës së paditur jane te mbeshketura ne ligjet e sipercituar.

Nga analiza e dosjes objekt gjykimi ky kolegji vlereson, se pala kerkuese ne referim te nenit 35 te ligjit nr.49/2012 nuk arriti te paraqesi prova që të provojë ligjshmërinë e kërkimeve si dhe faktet që ka parashtruar dhe ka vënë në themel te veprimtarise se kundershtruar ne gjykate nga pala kerkuese, kerkim i cili eshte rrezuar nga Gjykata Administrative te Shkalles se Pare Shkoder.

- Gjykata Administrative e Apelit çmon, se procedura e zhvillimit te ketij gjykimi rezulton te jete ne perputhje te plote me dispozitat e Kodit te Procedures Civile dhe te ligjit nr.49/2012. Nuk konstatohen shkelje si në proceduren e zhvillimit te gjykimit edhe ne proceduren e marrjes se vendimit nga gjykata e shkalles se pare.

- Kolegji Administrativ i Apelit ne analize te ankimit te paraqitur nga pala paditese ndaj vendimit nr.320 date 16.05.2017 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkoder e ne analize te akteve te dosjes si dhe ne referim te percaktimeve te ligjit material dhe procedural qe gjen zbatim ne rastin konkret çmon se : Vendimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkoder eshte rrjedhim i nje procesi te zhvilluar ne respektim te dispozitave te ligjit procedural dhe atij material dhe si i tille duhet te lihet ne fuqi.

#### **Vendim:**

- Lënien në fuqi të vendimit nr.320 datë 16.05.2017 të Gj.Ad.Sh.P.Shkodër
- Kundër vendimit lejohet rekurs

## **18. Vendim Nr. 2325 Datë 11.09.2019**

### **Gjykata Administrative e Apelit**

**Paditës:** Shoqëria tregtare "D.G" shpk, K91330502T

**I paditur:** Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë.

**Objekti:** Konstatimi I Pavlefshmerise Absolute te Raport Kontrollit dhe Njoftim Vleresimit Nr.\_ Dt.17.12.2015 dhe Vendimit DAT Nr.\_ Dt. 15.04.2016 te Drejtorise Rajonale Tatimore Durrës.

**Shuma e detyrimit tatimor:** 7,546,101 lekë

#### **Baza Ligjore:**

1. Ligji nr. 9920 dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.
2. Kodi I Procedurave Administrative Neni 32/a i; neni 11 dhe vijues
3. Ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
4. Kodit të Procedurave Administrative

#### **Përmbledhje e Fakteve:**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin Nr. 119, datë 20.02.2017 ka vendosur “Pranimin e pjesshem të Padisë”. Kundër këtij Vendimi ka paraqitur Ankim pala e paditur DRT Durres me pretendimet se Ne zbatim të Ligjit Nr. 8485 date 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperisë” neni 116 vihet re se

- a) Akti është nxjerrë nga DRT Durrës, organ kompetent për nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit
- b) Akti Njoftim Vlerësimi eshte nxjerre nga DRT Durres me Nr.\_ prot, date 17.12.2015, mbi bazen e perfundimit të kontrollit të kryer prane subjektit.
- c) Akti eshte nxjerrë në mënyrë zyrtare, në formen dhe elementët e parashikuar ne ligj

Pra pretendimi për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, nga ana e paditësit është i pabazë dhe është ngritur vetëm me qëllim për të shmangur nxjerrjen nga juridiksioni gjyqësor të kësaj çështjeje, pasi Drejtoria e Apelimit Tatimor nuk e ka shqyrtuar fare këtë rast, duke vendosur Refuzimin e Ankimit, për shkak se paditesi nuk ka përmbushur kërkesat e nevojshme ligjore për shqyrtim, të përcaktuara në nenin 107 pika 1 dhe 2 të ligjit 9920 dt 19.05.2008 dhe në Udhëzimin Nr. 24 dt 02.09.2008, paragrafi 107.1 dhe 107.3.1 në të cilat parashikohet se kriter për shqyrtimin e ankimit është pagesa e detyrimit, objekt ankimi ose garanci bankare për këtë shumë si dhe paraqitja e saj gjatë shqyrtimit të ankimit pranë DAT. Kjo kërkesë e palës paditëse ka penguar ezaurimin e ankimit të plotë administrativ, ndaj këtij akti, siç parashikohet nga Kodi I Procedurave Administrative dhe Ligji 49 /2012.

Arsyetimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Durrës, për të konstatuar se akti është pjesërisht absolutisht i pavlefshëm, në pjesën ku subjektit i janë nxjerre detyrime, për ato shkëmbime tregtare, ku ai pretendon se është nën regjimin e përpunimit aktiv, është i pabazë për arsyet si më poshtë:

-të gjithë Tatimpaguesit, të cilët kryejnë shkëmbime tregtare që klasifikohen si “Nën regjimin e përpunimit aktiv”, duhet të pajisen me Autorizimet përkatëse nga Administrata Tatimore sipas parashikimeve të Ligiit Nr. 7928 dt.27.04.1995 (neni 19)

Pra shprehet qarte në legjislacionin e sipërcituar, (ligjin material), në pikën 2 të nenit 19 të sipërcituar, se i është deleguar e drejta Ministrit të Financave, që të përcaktojë kushtet, se kur një furnizim është i përjashtuar. Ministri i Financave në Udhëzimin Nr 17 pika 8.13/c, ka përcaktuar se *“Autorizimet lëshohen nga Dega Përkatëse e Tatimeve dhe ky Autorizim ka dhe një afat vlefshmërie. Për pasojë, në mënyrë që një tatimpagues të përfitojë nga kryerja e shkëmbimeve tregtare pa paguar TVSH, duhet që të informojë paraprakisht Organin Tatimor në lidhje me palët e përfshira në këtë shkëmbim tregtar dhe koha në të cilin do të kryhet ky shkëmbim. Për këtë arsye lëshohen Autorizimet të cilat kanë datën e lëshimit dhe afatin e vlefshmërisë së tyre. Çdo shkëmbim tjetër tregtar jashtë këtij afati, do të konsiderohet si shkëmbim i tatueshëm me TVSH, pasi nuk ka marrë Autorizimin e nevojshëm për tu klasifikuar si Nën regjimin e përpunimit aktiv”*.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata Administrative e Apelit verën se lidhur me parashikimin që bën pika b e nenit 116 të K.Pr.Administrative, gjykata vlerëson, se në mënyrë një akt të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 116 gërma "b" të K.Pr.Administrative, është e nevojshme jo vetëm qënia si organ i identifikuar i administratës publike, por edhe pajisja nga ligji me tagrat e nxjerrjes së aktit administrativ. Çdo organi të administratës shtetërore I përcaktohet me ligji ose me akt nënligjor, kompetenca për fushën që ai mbulon, me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe detyrave brenda juridiksionit përkatës. Ushtrimi i kompetencave përtej kufijve të ligjit, përbën cënim të parimit të ligjshmërisë, fakt ky që konkludon në përfundimin se, vetëm në ato raste kur aktet administrative rezulton të jenë nxjerrë nga ana e organeve të administratës shtetërore në kapërcim të kompetencave të tyre ligjore, i bëjnë këto të fundit si akte administrative absolutisht të pavlefshme. Arsyetimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkalles së Parë Durrës, për të konstatuar se akti është pjesërisht absolutisht i pavlefshëm, në pjesën ku subjektit i janë nxjerre detyrime, për ato shkëmbime tregtare, ku ai pretendon se është nën regjimin e përpunimit aktiv, në vlerësim të këtij Kolegji është i pabazuar në ligj, kjo për faktin se, të gjithë tatimpaguesit, përfshirë edhe shoqërinë paditëse, të cilët kryejnë shkëmbime tregtare që klasifikohen si "Nën regjimin e përpunimit aktiv", duhet të pajisen me Autorizime përkatëse nga Administrata Tatimore sipas parashikimeve të Ligiit Nr. 7928, datë 27.04.1995 (neni 19)

**Vendim:** Ndryshimin e Vendimit Nr.119 Dt.20.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Durrës dhe Rrezimit të Padisë.